



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM  
KANCELARIJA GENERALNOG REVIZORA  
OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL

# RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT

## 2012



## Tabela e Përmbajtjes

FJALA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM.....	5
PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME.....	7
1 HYRJE.....	11
2 AUDITIMI I JASHTËM DHE LLOGARIDHËNIA.....	12
3 RAPORTI VJETOR FINANCIAR DHE LLOGARIDHËNIA E QEVERISË.....	14
3.1 Opinioni i Auditimit në Pasqyrat e Konsoliduara Financiare.....	14
3.2 Fushëveprimi dhe Qasja e Auditimit.....	16
3.3 Opinionet e auditimit në PVF individuale.....	16
3.4 Progresi i rekomandimeve nga viti i kaluar në lidhje me PVF/BK.....	17
3.5 Analiza e PVF/BK për 2012.....	18
3.5.1 Pasqyra e konsoliduar e krahasimit të shumave të buxhetuara me ato aktuale.....	18
3.5.2 Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave në Para të Gatshme.....	18
3.5.3 Pasqyrat e Konsoliduara në Para të Gatshme dhe Bilanci i Fondit.....	23
3.6 Pasuritë dhe Detyrimet e papaguara.....	23
3.6.1 Pasuritë.....	23
3.6.2 Detyrimet e pa paguara.....	24
3.7 Rekomandimet e përgjithshme.....	26
4 MENAXHIMI FINANCIAR.....	27
4.1 Sistemet e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MF/K).....	27
4.1.1 Zhvillimet aktuale.....	28
4.1.2 Procesi i Raportimit.....	29
4.1.3 Sistemi Standard i Integruar Qeveritar i Administratës Tatimore (SIGTAS).....	30
4.1.4 Prokurimi.....	30
4.1.5 Menaxhimi i Automjeteve Qeveritare.....	31
4.1.6 Reforma në Shërbimin Civil dhe Kompensimet.....	32
4.1.7 Menaxhimi i mbeturinave mjekësore.....	33
4.2 Sistemi i Auditimit të brendshëm.....	34
4.3 Konkluzionet e përgjithshme.....	36
4.4 Rekomandimet.....	36
5 REALIZIMI I BUXHETIT NË SEKTORIN PUBLIK.....	38
5.1 Autoritetet Qendrore.....	38
5.2 Institucionet e Pavarura (IP-të).....	41
5.3 Komunat.....	45
5.4 Ndërmarrjet Publike dhe Shoqërore.....	49
5.4.1 Ndërmarrjet Publike (NP).....	49
5.4.2 Ndërmarrjet Shoqërore.....	52
5.5 Privatizimi.....	53
Shtojca I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit.....	55
Shtojca II. Opinionet e auditimit dhe mangësitë kryesore menaxheriale.....	57

## Lista e Shkurtesave:

<b>AB</b>	Auditimi i Brendshëm	<b>MAP</b>	Ministria e Administratës Publike
<b>AKP</b>	Agjencia Kosovare e Privatizimit	<b>MASHT</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
<b>AKP</b>	Agjencia Kosovare e Pronës	<b>MF</b>	Ministria e Financave
<b>ANP</b>	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës	<b>MF/K</b>	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
<b>AP</b>	Auditori i Përgjithshëm	<b>MFP</b>	Menaxhimi i Financave Publike
<b>AQP</b>	Agjencia Qendrore e Prokurimit	<b>MI</b>	Ministria e Infrastrukturës
<b>ASHMDHP</b>	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	<b>MPB</b>	Ministria e Punëve të Brendshme
<b>ATK</b>	Administrata Tatimore e Kosovës	<b>MSH</b>	Ministria e Shëndetësisë
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian	<b>MZHE</b>	Ministria për Zhvillim Ekonomik
<b>BK</b>	Buxheti i Kosovës	<b>NP</b>	Ndërmarrjet Publike
<b>BQK</b>	Banka Qendrore e Kosovës	<b>NSH</b>	Ndërmarrjet Shoqërore
<b>FMN</b>	Fondi Monetar Ndërkombëtar	<b>NjAB</b>	Njësia e Auditimit të Brendshëm
<b>GJKK</b>	Gjykata Kushtetuese e Kosovës	<b>NjMPNP</b>	Njësia për Politika dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike
<b>IAP</b>	Institucioni i Avokatit të Popullit	<b>NjQH/AB</b>	Njësia Qendrore Harmonizuese/Auditimi i Brendshëm
<b>IGJK</b>	Instituti Gjyqësor i Kosovës	<b>NjQH/MFK</b>	Njësia Qendrore Harmonizuese/Menaxhimit Financiar dhe Kontrolli
<b>IP</b>	Institucionet e Pavarura	<b>OB</b>	Organizatata Buxhetore
<b>ISA</b>	Institucionet Supreme të Auditimit	<b>OE</b>	Operatori Ekonomik
<b>ISH</b>	Institucionet Shëndetësore	<b>OJQ</b>	Organizatata Jo-Qeveritare
<b>KA</b>	Komitetet e Auditimit	<b>OSHP</b>	Organi Shqyrtues i Prokurimit
<b>KASH</b>	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve	<b>PEFA</b>	Shpenzimet Publike dhe Llogaridhënia Financiare
<b>KBFP</b>	Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike	<b>PSH</b>	Prokurori i Shtetit
<b>KEK</b>	Korporata Energjetike e Kosovës	<b>PTK</b>	Posta dhe Telekomit i Kosovës
<b>KGJK</b>	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	<b>PVF</b>	Pasqyrat Vjetore Financiare
<b>KKTK</b>	Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor	<b>RAP</b>	Reforma e Administratës Publike
<b>KMFP</b>	Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike	<b>RTK</b>	Radio dhe Televizioni i Kosovës
<b>KPM</b>	Komisioni i Pavarur për Media	<b>RVA</b>	Raporti Vjetor i Auditimit
<b>KPMM</b>	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	<b>SIGTAS</b>	Sistemi i Administratës Tatimore
<b>KQZ</b>	Komisioni Qendror Zgjedhor	<b>SIMFK</b>	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar në Kosovë
<b>KRM</b>	Kompanitë Regjionale të Mbeturinave	<b>SNISA</b>	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
<b>KRRPP</b>	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	<b>SNKSP</b>	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
<b>LMFPP</b>	Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë	<b>SNRF</b>	Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
<b>LPNC</b>	Ligji për pagat e nëpunësve civil	<b>ZAMV</b>	Zyra Administrative e Mitrovicës së Veriut
<b>LPP</b>	Ligji nr. 03/L-241 për Prokurimin Publik	<b>ZAP</b>	Zyrat e Auditorit të Përgjithshëm
<b>LSHC</b>	Ligji për Shërbimin Civil	<b>ZKM</b>	Zyra e Kryeministrit

### Fjala e Auditorit të Përgjithshëm



Të nderuar anëtarë të Kuvendit,

Kam kënaqësinë e madhe që t'ju dorëzoj Raportin Vjetor të Auditimit të këtij viti. Ky raport mbulon zbatimin që Qeveria i ka bërë buxhetit 2012 dhe Pasqyrave Vjetore Financiare të Buxhetit të Kosovës për atë periudhë.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm vazhdon me misionin e saj themelor, të ofrojë bazën që shërben për t'i kërkuar llogari shpenzuesve publik dhe të kontribuojë në përmirësimet në fushën e Menaxhimit të Financave Publike.

Ne kemi punuar ngushtë me Kuvendin për të zgjeruar kapacitetin tonë në dhënien e informacionit të cilësisë së lartë mbi përdorimin e parasë publike. Ne gjithashtu kemi zhvilluar një bashkëpunim më të mirë me Qeverinë dhe akterët e tjerë vendor dhe ndërkombëtar në ndërtimin e qeverisjes së mirë dhe në kontribuimin për zhvillimin e sistemeve më të mira të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Cilësia e informacionit në Buxhetin e Kosovës dhe Raportet Vjetore Financiare të tij është përmirësuar nga viti në vit. Megjithatë, tani përballemi me pritshmëri dhe kërkesa më të mëdha mbi informata dhe statistika të sakta dhe të vlefshme në lidhje me ambiciet Euro-Atlantike të Kosovës. Ne mund të ndjehemi krenar me atë çka ka arritur Kosova në këtë fushë, por ende dalin sfida të reja.

Në të njëjtën kohë, ende ekziston nevoja për përmirësim në fokusin drejt produktivitetit dhe rezultateve të arritura dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Me zhvillimin e qasjeve

të menaxhimit financiar, korniza ligjore është duke u bërë më konsistente dhe mbikëqyrja e Kuvendit është duke u forcuar gradualisht. Përhapja e të gjitha këtyre objektivave në tërë sektorin publik merr kohë. Por, në kushtet aktuale mund të bëhet edhe më shumë me një qasje më të fokusuar.

Zbatimi i sistemeve dhe mekanizmave të menaxhimit financiar kërkon zotim dhe përkrahje nga nivelet më të larta. Qasje dhe metoda të reja si dhe shembujt e mirë se 'si ta bëjmë këtë' janë të nevojshme dhe duhet të përdoren. Më tutje, në rast të keqmenaxhimit dhe keqpërdorimit të fondeve publike duhet të ndërmerren veprime të palëkundshme.

Ne kemi dhënë rekomandime konstruktive për ndryshim, atëherë kur kemi gjetur dobësi, dhe kjo ka dhënë rezultate të mira. Ne përcjellim nga afër mënyrën se si adresohen rekomandimet tona dhe vazhdojmë të punojmë në partneritet të ngushtë me menaxhmentin për të promovuar përmirësimet. Ne synojmë të veprojmë si drejtuesi kryesor i pavarur për ndryshim në Menaxhimin e Financave Publike.

Sigurimi i zbatimit të parakushteve kryesore për të siguruar konsolidimin dhe qëndrueshmërinë e këtyre përmirësimeve si dhe një qasje që i shton vlerë procesit të integritetit, do të jenë fokusi im kryesor i strategjisë sime dalëse.

Ky raport paraqet sfidat kyçe, të cilat ne të gjithë duhet t'i adresojmë për të çuar përpara përmirësimet në sektorin publik. Shpresoj që ky raport do t'ju shërbejë si një mjet i dobishëm për identifikimin e fushave ku ne të punojmë të gjithë së bashku për t'i shërbyer sa më mirë qytetarëve të Kosovës.

Unë e lëvdoj këtë raport para anëtarëve të nderuar dhe pres me padurim diskutimet dhe përgjigjet tuaja.

Prishtinë, Shtator 2013



### Përmbledhje e Përgjithshme

Opinionimi im gjithëpërfshirës i auditimit nga Auditori i Përgjithshëm si përmbledhje nxjerr si përfundim se:

“Pasqyrat Vjetore Financiare të Buxhetit të Republikës së Kosovës, në të gjitha aspektet materiale, paraqesin një prezantim të vërtetë dhe të drejtë të financave dhe gjendjes financiare për vitin fiskal 2012”.

Në të njëjtën kohë ua kam tërhequr vëmendjen lexuesve në lidhje me prezantimin e pasurive. Pavarësisht nga kërkesat e raportimit të Thesarit që pasuritë mbi 1,000€ të prezantohen në PVF të BK-së në vlerën e tyre neto, informata në PVF themelore të OB-ve individuale dhe në PVF-të e BK-së ende nuk është harmonizuar si duhet. Pasuritë publike në PVF-të e BK-së janë nënvlerësuar me rreth 2,850,000,000€ në krahasim me PVF themelore individuale. Në të njëjtën kohë, pasuritë e prezantuara në PVF themelore nuk janë të sakta në shumë raste duke rezultuar në 42 Theksime të Çështjes për OB individuale. **(SNISA 400: Opinioni i Pakualifikuar i Auditimit me theksim të çështjes).**

Do të doja të ngris çështjet në vijim:

- Në PVF-të e BK-së, Thesari ka raportuar se nuk bën konsolidimin e transaksioneve ndër-departamentale në mënyrë që të ruaj konsistencën e informacionit të prezantuar në kuadër të PVF-ve të OB-ve. Kjo mund të ketë si efekt mbivlerësimin e qarkullimit të konsoliduar. Sipas mendimit tim, duhet të bëhet një konsolidim dhe të përshkruhet në fusnotë;
- Kosova gjatë vitit pranon fonde të ndryshme nga palë të treta (donacione), të cilat nuk lënë shprehje rregulloreve financiare të qeverisë (procesit buxhetor dhe të pagesave). Standardet e kontabilitetit dhe praktikata e mira ndërkombëtare kërkojnë që këto lloje transaksionesh të shpalosen në PVF-të e BK-së dhe në PVF individuale. Megjithatë, udhëzuesit qendror nuk janë mjaft të qartë dhe konsistent me standardet e kontabilitetit.

Çështjet e përmendura më sipër nuk janë materiale, por implementimi do të rezultonte në një regjim më transparent të kontabilitetit i cili është në pajtim me standardet dhe kërkesat e BE-së.

Në vijim do të përmbledh situatën rreth menaxhimit të financave publike dhe rekomandimet e detajuara të dhëna në kapitujt individual.

**Kapitulli 3 (Raporti Vjetor Financiar dhe Përgjegjësia e Qeverisë)** i këtij raporti tregon se raportimi financiar është përmirësuar dhe është bërë më transparent, si rezultat i adresimit të rekomandimeve të mëhershme që janë në proces të adresimit.

Në të njëjtën kohë, **Unë rekomandoj Qeverinë që të sigurojë:**

- Janë adresuar si duhet rekomandimet e mëparshme;
- Baza për theksim të çështjes në lidhje me konsolidimin e pasurive adresohet si çështje prioritare për të siguruar përmirësim të dukshëm për pozitën për vitin 2013;
- Dy sistemet qendrore të qeverisë për pasurinë janë unifikuar në mënyrë që të sigurojnë menaxhim më efikas të pasurive;

- Janë implementuar zgjidhje të duhura për trajtimin e borxheve të këqija, të dyshimta, dhe të pambledhshme, ri-pagimet e huave dhënë ndërmarrjeve publike dhe nivelit të detyrimeve të papaguara; dhe
- Konsideratat buxhetore reflektojnë ndikimin e donacioneve të reduktuara dhe pengesave në realizim të buxhetit.

### ***Unë po ashtu rekomandoj Kuvendin që të marrë parasysh:***

- Fokusimin në atë sa efektive është Qeveria në adresimin e rekomandimeve të dhëna dhe kërkimin e raporteve mbi progresin e bërë para se të hartohen PVF-të e BK-së për vitin 2013.

**Kapitulli 4 (Menaxhimi Financiar)**, mbulon Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK-në) si në qeverinë qendrore ashtu edhe atë lokale si dhe përmbushjen e reformave që lidhen me kërkesat e raportimit të jashtëm, sistemin qendror të prokurimit, menaxhimin e pasurive, përdorimin e parave të gatshme, reformën në administratën publike dhe sistemin e auditimit të brendshëm.

Derisa është bërë progres në kornizën legjislative dhe institucionale, zbatimi i kornizës ligjore është ende i dobët. Duhet të zhvillohet mjedisi i kontrollit, për të siguruar monitorim nga menaxhmenti i lartë, si dhe kontrollet operationale të nivelit më të ulët të implementohen në mënyrë efektive. Tema kryesore e rekomandimeve lidhet me çështjet që kanë të bëjnë me qartësimin e përgjegjësive, udhëzimeve dhe raportimin për të rritur këto kontrole.

### ***Në këtë kapitull, unë rekomandoj Qeverinë të sigurojë se:***

- Kërkesat e MFK-së zbatohen në praktikë nga organizatat e sektorit publik dhe secili menaxher të jetë proaktiv në zhvillimin e udhëzuesve të brendshëm që kanë të bëjnë me MFK-në;
- Është krijuar një kornizë model që do të shërbejë si mjet udhëzues për secilin menaxher, duke reflektuar nga jashtë dhe zbatuar në mënyrë efektive. Të aplikohet kontributi i auditimit të jashtëm dhe të brendshëm në mënyrë efektive;
- Janë shkëmbyer praktikat e mira dhe përvoja e fituar nga pilot projektet e KBFP;
- OB-të individuale zhvillojnë dhe zbatojnë një qasje efektive të menaxhimit të rrezikut në lidhje me objektivat organizative dhe misionin e tij;
- Kërkesat për raportimin e rezultateve dhe indikatorët e kostos zhvillohen si fushë me prioritet në kuadër të reformës së MFP-së. Duhet të analizohet mundësia për të bashkuar këtë raportim me raportimin financiar në PVF;
- Është zhvilluar plani i veprimit për të siguruar implementimin e plotë të SIGTAS;
- Korniza ligjore për administratë civile zbatohet në tërësi. Krijimi i një sistemi të ri të pagave të prioritetizohet, procesi i klasifikimit të vendeve të punës të finalizohet, dhe procesi i rekrutimit të bazohet në meritë dhe të kryhet në një mënyrë të hapur;
- Burimet e auditimit të brendshëm të përdoren nga secili menaxher në mënyrë më të fokusuar; dhe
- Është ndërmarrë një studim për të përcaktuar një kornizë të qëndrueshme të certifikimit për profesionin e Auditimit të Brendshëm në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare; dhe
- Është bërë një vlerësim strukturor i performancës së Komiteteve të Auditimit.

### ***Unë po ashtu rekomandoj Kuvendin që të marrë parasysh:***

- Lehtësimin për futje të shpejtë në përdorim të prokurimit elektronik i cili do të rrisë transparencën dhe redukton procedurat burokratike;
- Nxitjen e prokurimeve të centralizuara nga Qeveria në mënyrë që të sigurojë ekonomizimin dhe vlerën më të mirë për paratë e shpenzuara; dhe
- Gjetjen e një zgjidhje të qëndrueshme për kryerjen e shërbimeve të auditimit të brendshëm në institucionet e pavarura më të vogla duke nxitur kështu pavarësinë dhe llogaridhënien.

**Kapitulli 5 (realizimi i buxhetit në sektorin publik),** paraqet përmirësimet tek Autoritetet Qendrore kryesisht për shkak të progresit në raportim dhe politikave vjetore të planifikimit. Edhe pse është krijuar një mjedis i mirë i kontrollit, ende ka mangësi në aspekt të monitorimit dhe vlerësimit të rrezikut. Menaxhimi i shpenzimeve ka nevojë për llogaridhënie të zgjeruar të menaxhimit të brendshëm, sidomos në fushat e prokurimit dhe menaxhimit të fondeve.

Institucionet e pavarura janë për tu lavdëruar pasi kanë krijuar sisteme adekuate për menaxhim financiar dhe kontroll. Megjithatë, ekziston nevoja për përmirësim të planifikimit vjetor buxhetor dhe bashkëpunimit horizontal.

Komunat, në përgjithësi, kanë dështuar në adresimin e rekomandimeve nga vitet e kaluara, që ka rezultuar në përmirësim të ngadalshëm të menaxhimit të financave publike. Komunat janë ballafaquar me sfida menaxheriale dhe mangësi të tilla si: niveli i ulët i realizimit të buxhetit për investime kapitale, hyrja në obligime kontraktuale me burime të pamjaftueshme buxhetore, menaxhimi i dobët i projekteve kapitale dhe vonesa në ekzekutimin e punimeve, si dhe mungesa e kontrolleve në prokurim. Për më tepër, regjistrimi dhe shpалosja e pasurive mbetet një sfidë.

Shumica e Ndërmarrjeve Publike dhe Shoqërore vazhdojnë të operojnë me humbje financiare dhe varen nga subvencionet e qeverisë. Menaxhimi i prokurimit nuk është në përputhje me standardet dhe menaxhimi i burimeve njerëzore mbetet joefektiv. Komunat, si pronarë të NP-ve, kanë dështuar të krijojnë një rol mbikëqyrës dhe të miratojnë legjislacionin e nevojshëm për ta për të qenë operacional siç duhet në fushat e menaxhimit të mbeturinave. Mungesa e integritit dhe funksionimit të NSH Trepça si një e tërë, tregon se nevojiten përpjekje për të siguruar raportim financiar të unifikuar, transparencë dhe llogaridhënie.

AKP-ja edhe më tej përballlet me sfida dhe kontrolle të pamjaftueshme. Shpërndarja e 20% për punëtorët nga shitja e NSH-ve është vonuar, siç është edhe rasti me proceset e privatizimit dhe likuidimit.

### ***Në këtë kapitull, unë rekomandoj Qeverinë të sigurojë se:***

- Autoritet Qendrore obligohen të kryejnë vetë-vlerësimet e MFK-së dhe t'i raportojnë ato në MF brenda 6 muajve; dhe rishikojnë boshllëqet në rregullat përkatëse dhe udhëzimet e brendshme të MFK-së;
- Autoritet Qendrore kanë shqyrtuar më kujdes të gjitha rekomandimet e auditimit dhe të përgatisin një plan të rishikuar për adresimin e tyre;
- Ekziston transparencë e plotë dhe komunikim më efikas me Institucionet e Pavarura;

---

## ZYRA E AUDITORIT PËRGJITHSHËM

- Është rishikuar Korniza Raportuese për Komuna, janë krijuar forume në mes të Qeverisë dhe të ndërmarrjeve për të diskutuar sfidat me të cilat përballen dhe mundësitë për të përmirësuar performancën dhe shërbimet;
- Raporti i nxjerrë mbi operacionet e NP-ve përfshin një shkallë më të lartë të informacionit mbi performancën dhe arritjen e objektivave;
- Ka shkallë më të lartë të bashkëpunimit ndërmjet ministrive në lidhje me zbatimin e politikave dhe fushave të ndryshme të politikës;
- NJPMNP kryen përcjellje të rregullt se si NP-të adresojnë rekomandimet e dhëna nga ZAP; dhe
- Janë siguruar procedura për përzgjedhjen e Bordeve të Drejtorëve në NP.

### ***Unë po ashtu rekomandoj Kuvendin që të marrë parasysh:***

- Monitorim më të përafërt se si Qeveria adreson çështjet e përmendura përmes komisioneve përkatëse;
- Ofrimin e mbështetjes së plotë zyrës koordinuese dhe qartësimin e rolit të zyrës ndërlidhëse me Institucione të Pavarura në kuadër të Kuvendit për të siguruar informata të mjaftueshme për komisionet e Kuvendit;
- Shqyrtimin e mundësive për krijimin e kërkesave të reja raportuese, duke kombinuar raportimin financiar dhe raportimin operativ;
- Futjen në funksion të një Menaxheri Ekzekutiv si nëpunës më i lartë civil, përgjegjës për menaxhimin e aktiviteteve të përditshme dhe shërbimeve për qytetarët;
- Fuqizimin e mbikëqyrjes të performancës së komunave në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.
- Në mënyrë aktive përcjell veprimet e Qeverisë duke shikuar performancën e NP-ve në lidhje me politikat e vendosura operative;
- Që të kërkojë nga Bordi i AKP-së që të ofroj rregulla të qarta për mënyrën e administrimit, bashkëpunim të duhur mes menaxherëve të Trepçës,.
- Që të kërkojë PVF-të e unifikuara të Trepçës; dhe
- Krijimin e dispozitave që përcaktojnë qartë afatet kohore për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, për të mos lënë boshllëqe në funksionimin e Agjencisë;
- Se AKP mban të gjitha të ardhurat nga shitjet, transferimi, likuidimi i NSH-ve, me përjashtim të fondeve të suficitit, në mirëbesim për pronarët dhe kreditorët përfshirë edhe mbrojtjen e tyre; dhe
- Që të kërkojë nga AKP të thjeshtëzojë pasqyrat financiare për llogari të PF-ve në mënyrë që të jenë më të kuptueshme për lexuesit e jashtëm. E fundit por jo për nga rëndësia, unë rekomandoj Kuvendet Komunale që të sigurojnë se:
- Ekzekutivi harton plane veprimi të detajuara duke përfshirë aktivitetet, kohën dhe personat përgjegjës për adresimin e rekomandimeve të Auditorit të Jashtëm dhe Auditimit të Brendshëm; dhe
- Raportet e Auditorit të Jashtëm diskutohen në Kuvendet Komunale, dhe të ketë përcjellje të implementimit të rekomandimeve të dhëna nga Auditori i Përgjithshëm.

### 1 Hyrje

Në auditimin e vitit 2012, ZAP ka vazhduar në mënyrë aktive të adresojë objektivin e saj për të kontribuar në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike në sezonin e auditimit për vitin 2012. Fillimisht kjo është arritur përmes hartimit të një game raportesh të auditimit statutor (Auditim i Rregullsisë) dhe të auditimit jo statutor (Auditim i Performancës, Menaxherial, dhe i Sistemit), të cilat i janë dorëzuar Kuvendit. Për të mbështetur këtë objektivë në mënyrë aktive, gjithashtu kemi ndërmarrë një sërë aktivitete të tjera, ku përfshihen:

- Ndërlidhja dhe bashkëpunimi me projekte të ndryshme në fushën e Menaxhimit të Financave Publike (MFP);
- Mbështetja dhënë Komisioneve të Kuvendit dhe Qeverisë (ku kryesorja është Ministria e Financave) në fushat që synojnë forcimin e MFP-së;
- Pjesëmarrja në shumë aktivitete që synojnë ngritjen e vetëdijesimit mes politikanëve, shërbyesve civil, përfaqësuesve të shoqërisë civile, dhe medias; dhe
- Një dialog më të avancuar me entitetet e audituara, veçanërisht në lidhje me përcjelljen e rekomandimeve të dhëna më herët.

Ky raport ofron një përmbledhje të punës tonë audituese dhe përmban Opinionin e Auditimit të dhënë nga Auditori i Përgjithshëm (në pajtim me SNISA 400) për Pasqyrat Financiare të Qeverisë së Kosovës për vitin financiar 2012. Raporti gjithashtu nxjerr në pah ato çështje të cilat ne konsiderojmë se Qeveria dhe/ose Kuvendet duhet t'i adresojnë në mënyrë aktive për të përmirësuar Menaxhimin e Financave Publike. Në shumë raste, këto rekomandime reflektojnë tema të zakonshme të identifikuara në auditimin tonë bërë organizatave buxhetore (OB-ve).

Për auditimet e rregullsisë, hartimi i raporteve me cilësi të lartë është faza e fundit e procesit të auditimit vjetor. Para kësaj, ne ofrojmë një memo për fazën e ndërmjetme bazuar në PF-të nëntëmujore, ku i japim këshilla dhe udhëzime paraprake institucioneve të audituara. Ky proces dhe mbështetja konstruktive në fazën përfundimtare të auditimit lejon entitetet e audituara të rregullojnë gabimet në pasqyrat e tyre financiare dhe të përmirësojnë cilësinë e informacionit të shpalosur. Ai gjithashtu siguron drejtim të qartë në ato fusha ku Kontrollat e Brendshme duhet të përmirësohen. Këtë sezon, u fut në përdorim një format i ri i raportit të auditimit, i cili ndërlidh më qartë të gjeturat tona të auditimit me rrezikun që i shoqërohet entitetit të audituar përfshirë edhe rekomandimin tonë. Kjo është pranuar mirë nga institucionet e audituara. Në një numër të konsiderueshëm auditimesh, rekomandimet tona janë pranuar pa asnjë koment. Format e tjera të raportimit të auditimit janë të dizajnuara që të jenë konstruktive në mënyrë të ngjashme. Raporti Vjetor i Auditimit i vitit të kaluar u diskutua dhe aprovua në seancën plenare të Kuvendit. Parashihet që një proces i ngjashëm të ndiqet edhe këtë vit, dhe për të ndihmuar për një rishikim të fokusuar të çështjeve relevante, ne kemi organizuar raportin si në vijim:

- Kapitulli 2 ofron një shpjegim më të gjerë të rolit të auditimit të jashtëm dhe kërkesave për llogaridhënie;
- Kapitulli 3 ofron Opinionin për Pasqyrat Vjetore Financiare të Buxhetit të Kosovës (PVF të BK-së) dhe nxjerr në pah çështjet e dala nga ai auditim;
- Kapitulli 4 fokusohet mbi konkluzionet rreth Menaxhimit të Financave Publike (MFP), duke përfshirë ndikimin e Njesisë Qendrore Harmonizuese në kontekstin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit ashtu edhe të Auditimit e Brendshëm; dhe
- Kapitulli 5 vlerëson ekzekutimin e buxhetit nga institucionet publike të llojeve të ndryshme.

Ky raport përmban edhe dy shtojca. E para ofron llojet e ndryshme të opinioneve të auditimit të aplikuara nga ZAP, ndërsa e dyta përmbledh opinionet e dhëna të auditimit dhe mangësitë më domethënëse menaxheriale në secilin entitet të audituar. Më shumë informacion në lidhje me raportet individuale të auditimit mund të gjendet në faqen tonë zyrtare të internetit [www.oag-rks.org](http://www.oag-rks.org).

## 2 Auditimi i Jashtëm dhe Llogaridhënia

### Auditimi i Jashtëm

Si një Institucion Suprem i Auditimit (ISA), ZAP ndihmon procesin e llogaridhënies duke dhënë opinione rreth cilësisë së informacionit në Pasqyrat Vjetore Financiare. Përveç kësaj, fokusi është vënë mbi:

- Përdorimin e duhur dhe efektiv të fondeve publike;
- Zhvillimin e menaxhimit të shëndoshë financiar;
- Kryerjen e aktiviteteve administrative në mënyrën e duhur; dhe
- Komunikimin e informacionit relevant.

ZAP ka një rol kyç në promovimin e llogaridhënies në mes të Kuvendit, Qeverisë dhe institucioneve individuale si dhe brenda institucioneve të audituara. Raportet tona të auditimit sigurojnë një bazë për të kërkuar llogari nga menaxherët e OB-ve individuale. Gama e mbulimit tonë nëpërmjet auditimeve të ministrive, komunave dhe institucioneve tjera publike siguron mbulim të plotë në gjithë sektorin publik dhe janë konsoliduar në auditimin tonë të Buxhetit të Kosovës.

Duke i ofruar këto raporte të auditimit, ne kemi mbështetur Kuvendin në rolin e tij për të kërkuar llogari nga Qeveria në lidhje me menaxhimin e parasë publike. Numri i rritur i raporteve të shqyrtuara nga Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike (KMFP) e ka zhvilluar edhe më tej llogaridhënien në sektorin publik.

Pikënisja e auditimit tonë është auditimi statutor i rregullsisë, në të cilin ne ndërmarrim procedura auditimi gjithëpërfshirëse për të ofruar siguri të mjaftueshme mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si dhe aktivitetet operative në kuadër të institucioneve të audituara:

Auditimi i rregullsisë i jep Auditorit të Përgjithshëm bazën për të dhënë një opinion

- nëse pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive;
- nëse të dhënat, sistemet, dhe transaksionet financiare janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret; dhe
- për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe auditimit të brendshëm.

Gjatë kësaj pune, ne ofrojmë këshilla rreth çështjeve që lidhen me MF/K në të gjithë sektorin publik, duke vazhduar kështu me kontribumin tonë në zhvillimin e qeverisjes së mirë.

Puna që ne kryejmë në Auditimin jo statutor të Performancës synon të rrisë efektivitetin, ekonominë, dhe efikasitetin e aktivitetit të Qeverisë. Auditimi Menaxherial është një formë e auditimit të performancës, i fokusuar mbi cilësinë e menaxhimit financiar ose shërbimit të ofruar. Tek Auditimet e Sistemeve ne fokusohemi tek efikasiteti. Këto auditime na mundësojnë të ofrojmë një shpjegim më të gjerë mbi OB-të sesa thjesht një rezultat nga Auditimi i Rregullsisë.

### **Llogaridhënia dhe menaxhimi i ndryshimit**

Aktivitetet e detajuara më sipër i mundësojnë Auditorit të Përgjithshëm të promovojë parimet e llogaridhënies menaxheriale në të gjithë sektorin publik. Rekomandimet e dhëna në raportet e ZAP-it i drejtohen nivelit përkatës menaxherial dhe, në këtë raport, Kuvendit ose Qeverisë.

Raportet publikohen në faqen zyrtare të internetit të ZAP-it për të ofruar transparencë dhe rritur edhe më tej llogaridhënien.

Megjithatë, është e rëndësishme që veprimet e ZAP-it në këtë fushë të mbështeten nga zhvillimet e brendshme në institucione që zotërojnë sisteme dhe politika specifike, si dhe në institucione publike individuale që i zbatojnë ato. Kjo mund të mbështetet nga KBFP dhe zhvillimet e shoqëruara me Menaxhimin e Financave Publike, duke përfshirë vetëvlerësimet e ndërmarra nga institucionet publike. Megjithatë, zyrtarët përgjegjës duhet të kenë një fokus specifik dhe të vazhdueshëm në:

- rezultatet operacionale të institucioneve;
- sistemet e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, që mbulojnë të gjitha aspektet e veprimitarisë së institucioneve; dhe
- një Njësi Auditimi të Brendshëm, e pavarur në funksion dhe me një fokus të gjerë që përfshin rreziqet që lidhen me mos arritjen e rezultateve të pritura.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme duke qenë se sektori publik po largohet nga fokusi i vetëm tradicional i të siguruarit se procedurat po ndiqen dhe se buxhetet po shpenzohen. Ndërkohë që ecim përpara, theksi do të vendoset mbi menaxherët përgjegjës për përmbushjen e objektivave të organizatës duke arritur vlerën më të mirë për paranë e shpenzuar. Kjo kërkon procedura efektive të menaxhimit të rrezikut që mbështesin përdorimin e burimeve.

### 3 Raporti Vjetor Financiar dhe Llogaridhënia e Qeverisë

#### Hyrje

Ministria e Financave (MF), në emër të Qeverisë duhet t'i dorëzojë Pasqyrat Vjetore Financiare të Buxhetit të Republikës së Kosovës (PVF/BK-së) të vitit fiskal jo më larg se me 31 Mars të vitit pasues. Me 28 mars 2013, Qeveria i ka dorëzuar këto pasqyra Kuvendit dhe Auditorit të Përgjithshëm (AP) për shqyrtim.

PVF-të e BK-së për Vitin Financiar 2012 duhet të hartohen mbi baza të kornizës së përgjithshme të krijuar nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) dhe në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik. Burimet e informatave për hartimin e PVF-ve të BK-së janë të dhënat përfundimtare të Librit Kryesor të proceduara nga ana e Sistemit Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK), i menaxhuar nga Thesari.

Në Deklaratën hyrëse, Ministri i Financave dhe Drejtori i Thesarit deklarojnë: "Ky raport është në përputhje të plotë me kërkesat dhe përkufizimet juridike të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP nr. 03/L-048), si dhe në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik, të bazuar në para të gatshme. Ne konsiderojmë dhe fuqishëm besojmë se këto Pasqyra Vjetore Financiare japin pamje të drejtë dhe të vërtetë të financave, transaksioneve, dhe gjendjes financiare të Institucioneve të Kosovës nga Buxheti Kosovës dhe fondet<sup>1</sup> e tjera të menaxhuara sipas LMFPP-së për vitin fiskal 2012".

PVF-të e BK-së për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2012 përmban tri Pasqyra kryesore:

1. Pasqyra e konsoliduar e pranimeve dhe pagesave në para të gatshmes;
2. Pasqyra e konsoliduar e krahasimit të shumave të buxhetuara me ato aktuale; dhe
3. Pasqyra e konsoliduar e pasurive në para të gatshme dhe bilanceve të fondit.

Neni 47.1 i LMFPP-së kërkon nga Auditori i Përgjithshëm të shpreh një Opinion të Auditimit, në pajtim me standardet e auditimit të njohura ndërkombëtarisht - SNISA 400 në lidhje me Pasqyrat Financiare. Ky kapitull adreson Opinionin e AP-së dhe konkluzionet kryesore që mbështesin opinionin.

#### 3.1 Opinioni i Auditimit në Pasqyrat e Konsoliduara Financiare

Opinionin gjithëpërfshirës i auditimit nga Auditori i Përgjithshëm si përmbledhje nxjerr si përfundim se:

"Pasqyrat Vjetore Financiare të Buxhetit të Republikës së Kosovës, në të gjitha aspektet materiale, paraqesin një prezantim të vërtetë dhe të drejtë të financave dhe gjendjes financiare për vitin fiskal 2012".

Si theksim i çështjes ne tërheqim vëmendjen tek prezantimi i pasaktë i pasurive në PVF-të e BK-së. Pavarësisht nga kërkesat e raportimit të Thesarit që pasuritë mbi 1,000€ të prezantohen në PVF të BK-së në vlerën e tyre neto, informata në PVF themelore të OB-ve individuale dhe në PVF-të e BK-së ende nuk është harmonizuar si duhet.

---

<sup>1</sup> Fondet në mirëbesim, Grandet e përcaktuara të Donatorëve dhe Huamarrjet

Pasuritë publike në PVF-të e BK-së janë nënvlerësuar me rreth 2,850,000,000€ në krahasim me PVF themelore individuale. Në të njëjtën kohë, pasuritë e prezantuara në PVF themelore nuk janë të sakta në shumë raste duke rezultuar në 42 Theksime të Çështjes për OB individuale.

*(SNISA 400: **Opinion i Pakualifikuar i Auditimit me theksim të çështjes**)*

### **Bazë për Theksim të Çështjes**

Gjatë analizimit të procesit të konsolidimit të PVF-ve të BK-së, ne kemi gjetur se PVF-të e BK-së dhe PVF-të individuale të OB-ve, përkundër rekomandimeve të dhëna viteve të kaluara, nuk janë konsoliduar në tërësi. Vlera e pasurisë në PVF-të e BK-së është 3,506,347,833€ derisa vlera totale e pasurisë të të gjitha OB-ve të prezantuara në PVF-të e tyre individuale është 6,356,716,095€.

Përveç kësaj, OB-të janë duke hasur sfida si në llogaritjen e vlerës së pasurive ashtu edhe regjistrimin e tyre diferencat kanë të ngjarë të jenë edhe më të madhe se sa tregohet nga shifrat e mësipërme. Më shumë detaje janë dhënë në seksionin 3.6.1 më poshtë.

Unë i kam dhënë Qeverisë kohë të mjaftueshme për ta adresuar situatën si duhet. Mungesa e progresit real më bën të arrij në përfundimin se tashmë nevojitet një Theksim i Çështjes, që të siguroj veprim të qartë mbi atë se çfarë është e nevojshme për të adresuar këtë problem.

### **Çështjet tjera të konsolidimit**

PVF-të e BK-së duhet të adresojnë edhe këto në vijim:

- Në PVF-të e BK-së Thesari ka raportuar se nuk bën konsolidimin e transaksioneve ndër-departamentale në mënyrë që të ruaj konsistencën e informacionit të prezantuar në kuadër të PVF-ve të OB-ve. Ky qëndrim i Thesarit mund të ketë si efekt mbivlerësimin e qarkullimit të konsoliduar. Sipas mendimit tim, duhet të bëhet një konsolidim dhe të përshkruhet në fusnotë;
- Kosova gjatë vitit pranon fonde të ndryshme nga palë të treta (donacione), të cilat nuk i nënshtrohen rregulloreve financiare të qeverisë (procesit buxhetor dhe të pagesave). Standardet e kontabilitetit dhe praktikat e mira ndërkombëtare kërkojnë që këto lloje transaksionesh të shpalosen në PVF-të e BK-së dhe në PVF individuale. Raportimi i këtyre pagesave nga organizatat buxhetore bëhet, në rastin më të mirë, i hamendësuar. Udhëzuesit qendror nuk janë mjaft të qartë dhe konsistent me standardet e kontabilitetit.

Çështjet e përmendura më sipër nuk janë materiale, por implementimi do të rezultonte në një regjim të kontabilitetit i cili është në pajtim me standardet dhe kërkesat e BE-së.

Njëkohësisht, auditimi ka zbuluar një numër mangësish që kanë të bëjnë me implementimin e buxhetit. Këto janë të përfshirë në komente për Menaxhimin Financiar dhe Sistemin e Kontrollit të Brendshëm që janë të përshkruara në Kapitullin 4.

### 3.2 Fushëveprimi dhe Qasja e Auditimit

Informatat kryesore për hartimin e PVF-ve të BK-së burojnë nga Libri Kryesor i menaxhuar nga SIMFK. PVF-të, gjithashtu përmbajnë informata shtesë për sa i përket bilanceve, pasurive dhe detyrimeve të nxjerra nga SIMFK dhe OB-të individuale të financuara nga BK.

Pranimet, pagesat dhe bilancet që ndërlidhen me BQK-në dhe Trustin e Kursimeve nuk janë pjesë PVF-ve të BK-së prandaj nuk përfshihen në këtë opinion.

Cilësia e informatave në PVF të BK-së vlerësohet përmes një rishikimi analitik (testimit dhe analizave) bazuar në konsolidimin e PVF-ve individuale. Rishikimi bëhet kryesisht në ndarjet buxhetore dhe shifrat e realizuara, si: gjendja e bilanceve, të dhënat e listës së pagave dhe Libri Kryesor (Free Balance) në SIMFK. Gjithashtu, bëhet vlerësimi i strukturës dhe klasifikimit të PVF-ve të BK-së në raport me kërkesat e SNKSP-së si dhe ligjet e rregulloret e zbatueshme. Nxirret një konkluzion i përgjithshëm bazuar në rezultatet e auditimeve individuale të rregullsisë për vitin 2012 përfshirë vlerësimin e gabimeve dhe mosveprimeve të identifikuara në atë nivel.

AP jep Opinionin e tij për PVF-të në pajtim me standardet e njohura ndërkombëtarisht - SNISA 400 dhe bazuar në konkluzionet më lart, jep rekomandimet përkatëse për Kuvendin dhe Qeverinë.

### 3.3 Opinionet e auditimit në PVF individuale

Ne kemi kryer auditimin statutor të rregullsisë së PVF-ve për 89 OB dhe dy organizatave jashtë buxhetit. Opinionet e dhëna për secilën OB reflektohet në opinionin e auditimit të PVF-ve të BK-së. Ndikimi i përgjithshëm i tyre ndërlidhet me nivelin agregat të anomalive në PVF-të individuale dhe ndikimin i tyre në BK. Opinionet e dhëna janë si në vijim:

**Tabela 1: Llojet e Opinioneve**

Llojet e Opinioneve	Number of opinion
Opinion i pa kualifikuar	37
Opinion i pa kualifikuar me Theksim të Çështjes	42
Opinion i kualifikuar	2
Opinion i kualifikuar me Theksim të Çështjes	5
Mohim i opinionit	3
<b>Gjithsej:</b>	<b>89</b>

79 nga gjithsej 89 opinione, ishin të pa kualifikuara, dhe 10 të mbetura (qoftë individualisht apo në total) nuk ishin materiale sa të ndikojnë në opinionin e përgjithshëm të auditimit të PVF-ve të BK-së. Përveç kësaj, 15 auditime jo statutore që kemi kryer na japin të dhëna për analiza rreth Menaxhimit të Financave Publike në sektorin publik.

### 3.4 Progresi i rekomandimeve nga viti i kaluar në lidhje me PVF/BK

RVA për vitin 2011 ka dhënë një numër rekomandimesh kryesore për Qeverinë dhe Kuvendin, për tu adresuar brenda afateve të arsyeshme.

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike (KMFP) ka përmirësuar qasjen e tij në zhvillimin dhe zbatimin e llogaridhënies, duke mbajtur dëgjime publike me zyrtarët/Ministrat llogaridhënës të OB-ve lidhur me raportet e auditimit të ZAP-it, duke dhënë udhëzime dhe propozuar masat e duhura përmirësuese. Një fokus i veçantë i Komisionit ishte adresimi i implementimit të rekomandimeve nga ana e OB-ve.

Në auditimin e PVF-ve të BK-së për vitin 2011 janë dhënë gjithsej 11 rekomandime që ndërlidhen me këto pasqyra. Prej tyre, 10 i janë drejtuar Qeverisë, ndërsa një i është drejtuar Kuvendit. Nga rekomandimet e dhëna: tre janë adresuar, katër janë në proces të adresimit dhe katër nuk janë adresuar ende.

Rekomandimet e adresuara janë:

- Rregullimi i PVF-ve të secilës OB bëhet në kohën e duhur;
- Analizimin e thellë të shkaqeve për rritjen e detyrimeve dhe marrjen e masave të nevojshme për zvogëlimin e tyre; dhe
- Rishikimin e neneve mbi kompensimin për shërbimet investuese në marrëveshjen me BQK-në.

Adresimi i këtyre çështjeve ka rezultuar në përmirësimin e raportimit financiar dhe tani ai është më transparent. Adresimi i çështjes lidhur me detyrimet e papaguara ka rezultuar në rënie në vitin 2012.

Rekomandimet në proces të adresimit janë:

- Marrja e shpejtë e masave për të zgjidhur mos pajtueshmëritë midis sistemit të E-Pasurisë dhe SIMFK-së dhe ndërmarrjen e hapave për të zgjidhur dobësitë në modulën e zhvlerësimit në sistemin E-pasuria;
- Rivlerësimi i pasurisë që është zhvlerësuar plotësisht por që ende është në përdorim
- Marrja e masave nga MF për ngritjen e vetëdijesimit rreth kërkesave për vlerësimin dhe raportimin e pasurive; dhe
- Zbatimi i planit të veprimit në sektorin e të hyrave dhe veprimeve të mëtejshme të Qeverisë në lidhje me borxhin e KEK-ut ndaj shtetit.

Implementimi efektiv i këtyre rekomandimeve do të sigurojë përmirësimin e regjistrimit të pasurisë dhe vlerësimeve të ndërlidhura me të si dhe një llogaritje më të drejtë të taksave të papaguara të mundshme për tu inkasuar.

Rekomandimet ende të pa adresuara janë:

- Çregjistrimi i borxheve të këqija tatimore;
- Hartimin e një propozimi qeveritar për mënyrën e trajtimit të borxheve tatimore të këqija dhe të dyshimta që lidhen me ndërmarrjet publike;
- Sqarimin me kohë të borxhit të KEK-ut ndaj shtetit, para se të bëhet privatizimi; dhe
- Konsolidimi i duhur i transaksioneve ndërqeveritare (shih seksionin 3.1 më lart).

Mos implementimi i këtyre rekomandimeve potencialisht do të rezultojë në humbje financiare dhe raportim të vazhdueshëm të pasaktë.

---

### 3.5 Analiza e PVF/BK për 2012

Buxheti për vitin 2012 është përgatitur dhe aprovuar në përputhje me ligjin nr.04/L-079. Ashtu si e parasheh ligji, është ndërmarrë rishikimi gjashtëmuor i buxhetit ku janë bërë edhe një sërë ndryshimesh.

Miratimi i buxhetit për vitin 2012 (Ligji no.04/L-079) ishte bërë brenda afateve të përcaktuara ligjore, 11 dhjetor 2011. Në mes të vitit është bërë edhe rishikimi i buxhetit dhe janë bërë një sërë rregullimesh.

Me rishikim të buxhetit kishin ndodhur ndryshime të buxhetit në nivel të përgjithshëm dhe në nivel të OB-ve. Po ashtu, kishte ndryshime edhe nëpër kategori të ndryshme ekonomike brenda organizatave buxhetore. Përveç kësaj gjatë vitit Qeveria kishte marrë një numër vendimesh me të cilat ka reduktuar fondet dhe alokimet e organizatave të ndryshme buxhetore. Realizimi i buxhetit edhe këtë vit është përcjellë me mangësi të ndryshme. Reduktimi i fondeve dhe alokimeve nga ana e Qeverisë ka ndikuar që një numër i projekteve të barten për realizim në vitin pasues. Nga testimi i 97 projekteve kapitale të aprovuara, buxheti për 12 prej tyre nuk ishte implementuar fare.

#### 3.5.1 Pasqyra e konsoliduar e krahasimit të shumave të buxhetuara me ato aktuale

**Tabela 2: Buxhetimi dhe realizimi i pranimeve në raport me pagesat (€000)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Realizimi	Përqindja
Pranimet	1,544,606	1,537,955	98.8%
Pagesat	1,547,912	1,466,457	94.7%
<b>Suficit/Deficit</b>	<b>(3,306)</b>	<b>71,498</b>	-

Në projeksionet buxhetore shihet se të hyrat (pranimet) e planifikuara me buxhet fillestar janë më të ulëta se shpenzimet e planifikuara. Në Ligjin e Buxhetit për vitin 2012 është planifikuar me deficit në vlerë prej 3,306,000€. Deficiti është parashikuar të mbulohet me suficitin e akumuluar në vitet e mëparshme.

Faktikisht, inkasimi i të hyrave ishte më i ulët sesa ishte planifikuar (98.8%) në të njëjtën kohë që pagesat ishin akoma më të ulëta (94.7%), duke rezultuar kështu në një suficit prej 71,498,000€.

Shqetësim tjetër është fakti se buxheti final në krahasim me atë fillestar ishte rritur për vlerën 50,000,000€, përderisa buxheti fillestar nuk është implementuar. Kjo tregon se procesi i planifikimit dhe realizimit të buxhetit lë vend për analizë dhe përmirësim të mëtejshëm.

#### 3.5.2 Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave në Para të Gatshme

##### 3.5.2.1 Analiza e pranimeve në para të gatshme

Kjo analizë financiare bazohet në të dhënat e prezantuara në PVF-të e BK-së, duke e krahasuar me të dhënat e përfshira në SIMFK. Pranimet tjera përfshijnë: depozitat e fondit, gjobot dhe tarifatat, dividendët, kthimin e menjëhershëm të financimit të kredive nga NP-të.

Gjatë vitit ishin mbledhur 1,537,955,000€ (96.3% e buxhetit). Këtu nuk janë përfshirë grantet e përcaktuara të donatorëve në vlerë prej 11,322,000€ dhe depozitat në vlerë prej 1,338,000€. Rritja e pranimeve krahasuar me vitin 2011 është rezultat i inkasimit më të lartë të taksave, letrave me vlerë shtesë, kredive të FMN-së dhe financimi nga AKP-ja, etj. Tabela në vijim paraqet pranimet e realizuara në raport me planifikimin, krahasuar me dy periudhat paraprake.

## RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT 2012

**Tabela 3: Buxheti dhe realizimi i pranimeve sipas burimeve të ndryshme për vitin 2012 (në 000€)**

TË HYRAT DHE PRANIMET TJERA	Buxheti final	Realizimi 2012	% realizimi i buxhetit	Progresi krahasuar me vitin paraprak	Realizimi 2011	Realizimi 2010
	A	B	C= (B/A)	D= (B-E/E)	E	F
Të hyrat nga Dogana	874,700	844,861	96.59%	2.07%	827,704	700,657
Kthimet nga Dogana	(2,200)	(2,074)	94.27%	86.51%	(1,112)	(1,272)
Të hyrat nga ATK	287,800	283,915	98.65%	8.72%	261,134	221,234
Kthimet nga ATK	(32,800)	(32,763)	99.89%	10.04%	(29,774)	(27,017)
<b>I. Gjithsej të hyrat tatimore</b>	<b>1,127,500</b>	<b>1,093,939</b>	<b>97.02%</b>	<b>3.40%</b>	<b>1,057,952</b>	<b>893,602</b>
Të hyrat jo tatimore- niveli qendror	48,100	41,145	85.54%	-9.6%	45,525	47,412
Të hyrat Vetjake të Komunave	62,819	59,448	94.63%	6.88%	55,621	52,028
Të hyrat Vetjake të nivelit qendror	51,100	44,835	84.74%	-25.16%	59,912	48,451
<b>II. Gjithsej të hyrat jo tatimore</b>	<b>162,019</b>	<b>145,428</b>	<b>89.76%</b>	<b>-9.7%</b>	<b>161,058</b>	<b>147,891</b>
Dividentat	45,000	45,000	100%	-25%	60,000	85,000
Të hyrat e dedikuara të AKP-së	16,248	16,248	100%		-	-
Financimi i njehershëm i AKP-së	28,934	28,934	100%		-	-
Kthimi i huasë nga NP	4,000	4,000	100%		-	-
Pranimet nga emetimi i letrave me vlerë	74,000	73,313	99.07%		-	-
Huazimet nga FMN	104,000	93,677	90.07%	1,745%	5,076	22,093
Grantet për përkrahje të buxhetit	35,000	37,417	106.9%	94.47%	19,240	30,000
<b>III. Gjithsej Pranime tjera</b>	<b>307,182</b>	<b>298,589</b>	<b>97.20%</b>	<b>254%</b>	<b>84,316</b>	<b>137,093</b>
<b>Gjithsej pranimet I+II+III</b>	<b>1,596,701</b>	<b>1,537,955</b>	<b>96.32%</b>	<b>18%</b>	<b>1,303,326</b>	<b>1,178,586</b>

### a) Realizimi i të hyrave tatimore nga Doganat

Të hyrat e planifikuara doganore për vitin 2012 ishin 873,700,000€, ndërsa janë mbledhur 842,787,317€ ose 96.5%. Niveli i të hyrave në vitin 2012, krahasuar me 2011, është rritur për 2%.

Për sa i përket procesit të mbledhjes së të hyrave, Dogana ka treguar progres në raport me vitin e kaluar. Veçanërisht kjo vërehet te llogaritja e saktë e tarifave për taksat dhe rivlerësimin e bazës doganore. Megjithatë, raportimi i vonuar nga Operatorët Ekonomik për gjendjen e stokeve dhe mungesa e licencimit të përfaqësuesve doganor, mbetet çështje për përmirësim.

Raporti individual i auditimit tregon se kontrollet në Doganë duket të jenë të dizajnuara mirë, janë zbatuar siç është planifikuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive.

Në përgjithësi, rritja e çmimeve në tregun botëror në veçanti çmimet e larta të naftës ka pasur ndikim në rritjen e vazhdueshme të të hyrave doganore nëpër vite që nga viti 2010.

**b) Realizimi i të hyrave tatimore nga ATK**

Të hyrat e planifikuara nga ATK për vitin 2012 ishin 288,000,000€, ndërsa janë mbledhur 284,000,000€ apo 99% të planit. Në krahasim me vitin 2011, pagesat janë rritur për 8.7%.

Borxhet më të vjetra se gjashtë vjet kanë arritur vlerën 104,000,000€. Ajo përfshinë periudhën nga viti 2000 deri në 2006. Gjatë këtij viti, shuma prej 22,000,000€ është bërë ligjërisht e pa mbledhshme për shkak të tejkalimit të pragut prej gjashtë vitesh. Mos mbledhja e këtyre detyrimeve do të ketë një ndikim të theksuar në buxhetin total të Kosovës.

Shkalla e lartë e borxheve të pa mbledhura dhe tentimet e pakta për të adresuar këtë situatë, e sidomos borxhet e vjetra vështirëson gjasat për mbledhjen e tyre.

**c) Dividentat**

Qeveria është aksionari i vetëm i autorizuar për Dividentat e deklaruara nga Posta dhe Telekom i Kosovës (PTK) dhe Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës (ANP). Në Buxhetin e vitit 2012, janë planifikuar të hyra nga dividentat në vlerë prej 46,000,000€, ndërsa nga PTK janë pranuar 45,000,000€.

Të hyrat nga dividentat, në krahasim me vitin paraprak janë më të vogla për 15,000,000€. Ndër arsyet kryesore për këtë është rritja e konkurrencës në tregun e shërbimeve të telekomunikimit.

**3.5.2.2 Analiza e Pagesave në para të gatshme**

Shpenzimet e planifikuara për vitin 2012 (pa donacione dhe depozita) për të gjitha kategoritë ishin 1,585,744,000€, ndërsa 1,466,457,000€ ose 92.48% e shumës së planifikuar ishte realizuar.

**Tabela 4: Shpenzimet aktuale kundrejt buxhetit**

(në 000 €)

Përshkrimi	Buxheti Final	Realizimi 2012	%	Krahasimi 2012-2011	Realizimi 2011	Realizimi 2010
Pagat dhe mëditjet	415,285	407,706	98.17%	5.89%	385,033	311,417
Mallrat dhe shërbimet	193,161	169,362	87.68%	8.18%	156,559	162,635
Shpenzimet komunale	23,445	21,558	91.95%	5.80%	20,376	19,516
Subvencionet dhe transferet	292,475	280,120	95.78%	9.35%	256,166	252,679
Shpenzime kapitale	623,551	550,245	88.24%	4.18%	528,186	455,344
Rezervat	361	0	0.00%		-	-
<b>Nën totali</b>	<b>1,548,278</b>	<b>1,428,991</b>	<b>92.30%</b>	<b>6.14%</b>	<b>1,346,319</b>	<b>1,201,591</b>
Pagesa e Borxhit	21,416	21,416	89.68%	95.51%	11,491	10,083
Huazimet për ndërmarrjet publike	15,000	15,000	100.00%	-50.00%	30,000	60,000
Anëtarësimi në Institucionet Ndërkombëtare <sup>2</sup>	1,050	1,050	0.00%		-	169
<b>Nën totali</b>	<b>37,466</b>	<b>37,466</b>	<b>93.55%</b>	<b>-9.70%</b>	<b>41,491</b>	<b>70,252</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>1,585,744</b>	<b>1,466,457</b>	<b>92.48%</b>	<b>5.67%</b>	<b>1,387,810</b>	<b>1,271,843</b>

<sup>2</sup> Vlera prej 1,050,000€ në kolonën e vitit 2012 është paguar për anëtarësimin e Kosovës në BERZH. Ndërsa vlera prej 169,000€ në kolonën e vitit 2010 është pagese për anëtarësim në Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN).

## RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT 2012

Nga tabela vërehet se gjatë vitit 2012 krahasuar me buxhetin final, ka pasur një nivel të ulët të realizimit të planit sidomos tek mallrat dhe shërbimet me 87.68% dhe investimet kapitale me 88.24%. Realizimi i ulët i buxhetit rrjedh si rezultat i sfidave të vazhdueshme në zbatimin e proceseve të prokurimit dhe planifikimit të dobët të projekteve.

Mangësi kishte edhe tek dinamika e realizimit të buxhetit, duke pasur parasysh se kishte mospërputhje në mes të shpenzimeve dhe planit të rrjedhës së parasë. Tek shumica e OB-ve është vërejtur tendenca e rritjes së shpenzimeve në muajt e fundit të vitit duke u përpjekur të shmangin suficitin buxhetor. Për shkak të kësaj, disa pagesa janë bërë në kundërshtim me Ligjin e Buxhetit.

**Tabela 5: Totali i pagesave përfshirë donacionet:**

(në €)

Përshkrimi	Realizimi 2012	Realizimi 2011	Realizimi 2010
Pagesat pa donacione (tabela 4)	1,466,457,000	1,387,810,000	1,271,843,000
Pagesat nga Donacionet	9,427,000	11,729,000	14,050,000
Pagat dhe mëditjet	1,539,000	3,270,000	4,782,000
Mallrat dhe shërbimet	3,120,000	5,032,000	4,523,000
Shpenzimet komunale	3,000	12,000	12,000
Subvencionet dhe transferet	197,000	311,000	805,000
Shpenzime kapitale	4,568,000	3,104,000	3,928,000
Kthimet e Fondeve të depozitave	190,000	922,000	1,632,000
<b>Gjithsej Pagesat</b>	<b>1,476,074,000</b>	<b>1,400,462,000</b>	<b>1,287,525,000</b>

Siç tregohet në tabelën e mësipërme, gjatë tre viteve të fundit ka pasur një trend në rritje të shpenzimeve qeveritare, ndërsa donacionet janë zvogëluar. Kjo mund të rrisë boshllëkun buxhetor nëse nuk adresohet siç duhet.

### a) **Klasifikimi i gabuar i kodeve ekonomike**

Ne kemi vërejtur se një numër i OB-ve ende vazhdojnë të kenë probleme me klasifikimin dhe regjistrimin e shpenzimeve në kodet dhe kategoritë ekonomike përkatëse. Regjistrimi i shpenzimeve në mallra dhe shërbime dhe investime kapitale bëhet në mënyrë të gabuar. Raste të tilla janë vërejtur në tetë Ministri, shtatë Komuna, nëntë Institucione të Pavarura, Zyrën e Kryeministrit (ZKM) dhe Zyrën e Presidentit (ZP).

Arsye për klasifikim të gabuar në disa raste janë mungesa e njohurive të mjaftueshme të zyrtarëve përkatës për të aplikuar Planin Kontabël të Thesarit, e në disa raste të tjera për të mbuluar pagesa të cilat nuk janë të planifikuara me kohë. Kjo rezulton me anomali të informatave në Pasqyra Financiare edhe pse nuk janë materiale për PVF-të përkatëse.

### **b) Subvencionet dhe transferet**

Shuma e paguar për Subvencione dhe transfere gjatë vitit 2012 ishte 280,317,000€. Prej tyre, 52,184,000€ janë paguar për entitete publike.

Rishikimet analitike të subvencioneve, me theks të veçantë atyre për entitete publike, kanë nxjerrë në pah se në kodin ekonomik 'Subvencione për entitete publike' janë regjistruar edhe përfitues individual, OJQ dhe biznese, të cilët janë përfitues jo publik.

Shuma e regjistruar e përfituesve jo publik si përfitues publik (në €) është si me poshtë:

- Përfitues individual .....764,082
- Organizata jo Qeveritare.....16,774,165
- Biznese.....752,659
- **Gjithsej ..... 18,290,906**

OB-të, nuk kanë bërë regjistrimin e shpenzimeve në kode ekonomike adekuate. Kishte raste kur subvencionet për entitete jo publike ishin regjistruar në ato publike. Po ashtu, barazimet e thesarit me llogaritë e shpenzimeve të OB-ve përfshinin gabime që nuk janë korrigjuar.

### **c) Huazimet për ndërmarrje publike**

Gjatë periudhës 2005-2011, Qeveria i ka huazuar fonde KEK-ut në shumën prej 187,539,992€, duke kërkuar kthimin e kryegjësë dhe pagesën e interesit si kundër shpërblim.

Përkundër faktit se pagesat e pritura nuk janë bërë, Qeveria edhe gjatë vitit 2012 i ka huazuar KEK-ut fonde shtesë në vlerë 15,000,000€.

Sipas një marrëveshje të vitit 2005, kredia e dhënë në vlerë 10,000,000€ duhet të paguhej nga KEK-u deri në fund të vitit fiskal 2008.

Në Tetor të vitit 2011, MF-ja ka bërë një "Marrëveshje për Ujdi" me KEK-un sipas së cilës, shumën prej 10,000,000€, kjo e fundit do ta paguaj në këste, 4,000,000€ gjatë vitit 2012 ndërsa 6,000,000€, gjatë vitit 2013. Edhe pse me vonesë, në mars 2012, KEK-u kishte bërë pagesën në vlerë prej 4,000,000€. Plani i amortizimit të kredisë është deri në vitin 2022.

ZAP ka përcjellë procesin e ri-pagimit për vite me radhë, me synimin që të ndihmojë në gjetjen e një zgjidhje në lidhje me ri-pagimin. Deri në kohën e raportimit, edhe pse procesi i ri-pagimit ka filluar, nuk ka pasur ndonjë progres domethënës. Huat nuk janë kthyer brenda afateve të parapara në marrëveshjen për hua.

### 3.5.3 Pasqyrat e Konsoliduara në Para të Gatshme dhe Bilanci i Fondit

Paraja e Gatshme përmban fonde që mbahen në BQK, Banka komerciale dhe arkat e buxhetit të OB-ve. Kemi bërë analiza duke krahasuar Pasqyrën e Konsoliduar të pasurive financiare në para të gatshme dhe bilanceve të fondit me bilancet e viteve të mëparshme

**Tabela 6: Pasuritë në para të gatshme dhe bilancet e fondit** ('000 në €)

Përshkrimi	Bilanci në 2012	Bilanci në 2011	Bilanci në 2010
Banka Qendrore e Kosovës	73,697	89,326	48,796
Letra me vlerë	45,996	0	84,586
Depozitat e afatizuara në BQK	152,007	105,042	140,000
Depozitat e afatizuara në Banka Komerciale	0	0	11,000
Fondet në bankat komerciale - NLB Prishtina	0	41	767
Paratë e gatshme në transit	5,115	7,074	4,278
Llogaritë e Ambasadave	448	961	526
Paratë e gatshme në dorë (arka)	907	1,184	885
<b>Gjithsej Pasuritë në Para të Gatshme</b>	<b>278,170</b>	<b>203,628</b>	<b>290,838</b>

Nga tabela vërehet një rritje e parasë së gatshme në fund të vitit për 74,542,000€ që kryesisht ndërlidhet me para të gatshme të gjeneruara në fund të vitit. Paraja e Gatshme në fillim të vitit 2012 ishte 203,628,000€, ndërsa në fund të vitit 2012 ishte 278,170,000€.

### 3.6 Pasuritë dhe Detyrimet e papaguara

#### 3.6.1 Pasuritë

Pasuritë e OB-ve qendrore dhe lokale të regjistruara në sistemin kontabël SIMFK në fund të vitit 2012 ishin në vlerë neto prej 3,506,347,833€. Prej tyre, vlera e pasurisë vetëm të OB-ve në nivele qendrore ishte 1,790,114,595€ derisa të OB-ve të nivelit lokal ishte 1,716,233,238€.

Në krahasim me vitin 2011, pasuritë në nivelin qendror ishin rritur për 413,287,375€ derisa në nivelin lokal për 316,567,015€.

Gjatë krahasimit të PVF-ve të BK-së për vitin 2012 me të dhënat e prezantuar në PVF të OB-ve për pasuritë, kemi identifikuar se tek 27 OB të dhënat e PVF-ve individuale nuk përputheshin me ato të BK-së. Kjo ka reflektuar në jo konsistencë dhe diferenca në raportimin e pasurive. Disa OB kanë prezantuar Pasuritë me vlerën blerëse, disa me vlerën neto, ndërsa disa tjera kanë rivlerësuar pasuritë e tyre por duke mos i korrigjuar në SIMFK (modulin e pasurive).

Disa OB nuk janë duke i trajtuar si duhet pasuritë e tyre në regjistrat kontabël, dhe nuk i raportojnë ato në pajtim me politikat kontabël të Qeverisë. Standardet e kontabilitetit dhe udhëzimet e Thesarit përcaktojnë që vlera e pasurive në Librin e Përgjithshëm të bartet prej vitit në vit, duke e zbritur zhvlerësimin për vitin aktual.

Në katër OB (komuna)<sup>3</sup> Pasuritë jo-financiare nuk janë raportuar fare dhe nuk dihet sa është vlera e tyre. Tek disa OB, sidomos tek ato të nivelit lokal (komunat) ka ende Pasuri të pa regjistruara dhe të pa prezantuara, siç janë objektet shkollore, tokat dhe pasuri të tjera në pronësi të tyre.

Ndër arsytet e mos raportimit është përcaktimi i paqartë i pronarit/titullarit të pasurisë për shkak të kontesteve të trashëguara nga sistemi i mëparshëm.

Prezantimi jo i duhur dhe i pasaktë i pasurive jo financiare në PVF-të e OB-ve dhe në ato të BK-së ka rezultuar në nënvlerësim material të pasurive publike në vlerë prej 2,850,368,262€. Vlera e pasurive në PVF-të BK-së është 3,506,347,833€ ndërsa totali i pasurive të të gjitha OB-ve të mbledhura nga PVF-të e tyre është në vlerë 6,356,716,095€. Kjo ka ndodhur si rezultat se në PVF të BK-së janë shfrytëzuar shënimet e SIMFK-së e jo të PVF-ve të OB-ve individuale. Megjithatë ky ndryshim ka gjasa të nënvlerësohet si pasojë e efektit neto të:

- Disa OB kanë prezantuar vlerën bruto të pasurive të tyre
- Mos regjistrimi i të gjitha pasurive në PVF-të individuale (që ka rezultuar në 42 Theksime të Çështjes);

Sfidat tjera që duhet të trajtohen sa i përket sistemit të menaxhimit të pasurive janë:

- Regjistrimi jo i plotë i pasurisë në Regjistrin kontabël SIMFK dhe Regjistrin e Pasurisë;
- Mos harmonizim i të dhënave ndërmjet regjistrit kontabël dhe regjistrit të pasurisë;
- Jo të gjitha OB-të kishin formuar komisione dhe kishin përfunduar procesin e inventarizimit të pasurisë;
- Mos harmonizimi i regjistrit të pasurisë me raportin e inventarizimit; dhe
- Mbivlerësim i pasurive me rastin e bashkëfinancimit.

Me qëllim të sigurimit të një menaxhimi më efikas të pasurisë, Komisioni i Kuvendit për Mbikëqyrje të Financave Publike ka kërkuar nga Ministria e Administratës Publike (MAP) dhe MF që të krijojnë një grup të përbashkët pune për tejkalimin e jo-konsistencës në mes të dy sistemeve elektronike për menaxhimin e pasurive qeveritare (SIMFK dhe E-pasuria). Ne kemi marrë pjesë në takimet e grupit rregullisht si vëzhgues. Deri në përfundimin e këtij raporti, grupi ishte takuar disa here për të diskutuar rreth unifikimit të këtyre dy sistemeve për të evituar nevojën për regjistrime të dyfishta. Rezultatet konkrete mbetet të shihen në muajt e ardhshëm.

Nga fillimi i këtij viti, përbrenda këtij sistemi është vënë në funksion edhe moduli për zhvlerësimin e pasurisë duke hapur kështu rrugën për një raportim më të saktë të vlerave të pasurisë.

### 3.6.2 Detyrimet e pa paguara

Ne kemi krahasuar të dhënat e raportuara për faturat e papaguara sipas OB-ve nga Aneksi 9 i PVF-ve të BK-së, dhe Neni 15, Shënimi 28 nga PVF-të individuale.

Nga analizat e bëra, në nivel të përgjithshëm është vërejtur trend i zvogëlimit të obligimeve krahasuar me vitin paraprak. Veprime shtesë për përmirësimin e kësaj çështje janë marrë nga Departamenti i Thesarit si rezultat i rekomandimeve të ZAP-it. Rregulla që përcakton çështjen e obligimeve është azhurnuar nga Thesari në fund të majit të vitit 2013.

---

<sup>3</sup> Në Komunat: Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok, dhe Kllokot

## RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT 2012

Por, përkundër këtyre veprimeve, ende ka OB të cilave u janë rritur detyrimet e papaguara në raport me vitin paraprak. Tabela në vijim tregon një pasqyrim të gjendjes së obligimeve në tri vitet e fundit

**Tabela 7: Obligimet e papaguara krahasuar në tri vitet e fundit**

(në €)

Përshkrimi	2012	2011	2010	Zvogëlimi midis 2011 dhe 2012 (%)
Niveli Qendror	13,875,768	21,072,571	15,912,553	34
Niveli Lokal	12,811,832	18,123,248	12,623,776	29
<b>Gjithsej</b>	<b>26,687,603</b>	<b>39,195,819</b>	<b>28,536,329</b>	<b>32</b>

Arsyet më të shpeshta të mos pagesës nga OB-të individuale janë mungesa e fondeve (përveç se në disa raste kishte nënshpenzim buxhetor), planifikimi i dobët dhe kontrole të pamjaftueshme mbi pagesat për shërbimet që ndodhin në muajin Dhjetor. Por, ka arsye të tjera që lidhen me kërkesat e zotimit dhe proceset e pavolitshme të prokurimit. Gjithashtu, ka raste që faturat e pa paguara janë edhe të muajve dhe viteve të më hershme, që përkundër kërkesave të rregullës 04/2011 të Thesarit, nuk janë paguar me kohë. Kjo është pjesërisht si rezultat i kontrolleve të brendshme të pa mjaftueshme dhe pjesërisht çështje prioritizimi.

Në vijim prezantohet një tabelë me obligimet e OB-ve individuale për vitin 2012, të cilat barten për pagesë në vitin 2013..

**Tabela 8: Obligimet e pa paguara për vitin 2012**

(në €)

Organizatave buxhetore	Buxheti final 2012	Detyrimet e papaguara 2012	Buxheti final në %
Ministria e Punëve të Brendshme	95,319,726	2,881,123	3.02%
Ministria e Infrastrukturës	281,164,542	2,828,839	1%
Ministria e Shëndetësisë	91,304,015	2,630,047	2.88%
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	48,619,545	2,328,054	4.79%
Ministria e Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Çështjeve jo rezidente	18,592,289	750,375	4.04%
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	42,935,749	365,531	0.85%
Min. e Forcës së Sigurisë së Kosovës	34,311,877	238,417	0.69%
Universiteti i Prishtinës	26,262,998	226,396	0.86%
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	18,265,527	199,007	1.09%
Gjilan	19,018,422	3,291,930	17.31%
Skënderaj	10,644,759	1,503,086	14.12%
Mitrovica	18,250,442	1,301,000	7.13%
Shtërpca	4,300,521	1,076,158	25.02%
Prizren	32,714,018	933,000	2.85%
Peja	19,505,559	727,000	3.73%
Gjakova	19,740,824	710,798	3.60%
Deçan	6,765,377	594,000	8.78%
Lipjan	11,992,178	464,818	3.88%
Ferizaj	21,546,567	405,690	1.88%
Prishtina	79,126,542	375,000	0.47%
Podujeva	17,010,746	280,260	1.65%
<b>Totali:</b>	<b>917,392,223</b>	<b>24,110,529</b>	<b>2.63%</b>

Këto shuma të borxheve arrijnë vlerën prej 90% të detyrimeve totale. Komunitat si: Shtërpca, Gjilan, Skënderaj, institucionet si: MPB, MI, MSH, dhe MASHT kanë mbi 16,000,000€ detyrime të papaguara.

Ekziston rreziku real se OB-të ndonjëherë nuk i prezantojnë fare disa nga obligimet e krijuara gjatë tri viteve të fundit. Po që se u referohemi raporteve individuale të auditimit, vërehet se janë kryer pagesa të faturave për vitin 2010 dhe 2011, që fare nuk ishin prezantuar në pasqyrat financiare të viteve përkatëse.

### 3.7 Rekomandimet e përgjithshme

Disa nga rekomandimet e dhëna në vitin 2011 nuk janë adresuar dhe të njëjtat dobësi janë përsëritur në vitin 2012.

#### **Unë rekomandoj Qeverinë që të sigurojë se:**

- Janë adresuar rekomandimet e mëparshme rreth identifikimit të dobësive në kontroll dhe menaxhim të pamjaftueshëm;
- Baza për theksim të çështjes në lidhje me konsolidimin e pasurive adresohet si çështje prioritare. Një Task Forcë speciale duhet të raportojë në Kuvend brenda një periudhe tre mujore dhe që shqyrton çështjen e konsolidimit dhe dobësive në nivel të OB-ve sa i përket regjistrimit dhe vlerësimit të pasurive. Një Plan i Veprimit duhet të zbatohet për të arritur një përmirësim të dukshëm në pozitë për vitin 2013 në nivel të BK-së dhe niveli individual të OB-ve. Kjo gjithashtu duhet të adresojë udhëzimin, për shembull, amortizimin e pasurive dhe vlerësimin e pronave publike ku pronësia është subjekt i kontesteve, etj;
- MF dhe MAP ndërmarrin veprime të mëtejme për unifikimin e dy sistemeve qendrore të qeverisë për pasurinë në mënyrë që ato sisteme të jenë të përputhshme dhe të sigurojnë menaxhim më efikas të pasurive;
- Është gjetur një zgjidhje e duhur për trajtimin e borxheve të këqija, të dyshimta, dhe të pa mbledhshme dhe kjo të implementohet gjatë vitit 2013;
- MF-ja mbikëqyr nga afër zbatimin e marrëveshjes dhe për huatë dhënë ndërmarrjeve publike, të sigurohet se ripagimet bëhen brenda afateve të përcaktuara;
- Transparenca në PVF/BK-së është zhvilluar duke:
  - Klasifikuar dhe regjistruar të gjitha shpenzimet, me theks të veçantë subvencionet, në kodet adekuate të shpenzimeve;
  - Konsoliduar transaksionet ndërqeveritare; dhe
  - Përfshirjen e plotë të pagesave të treta.
- Ndikimi i donacioneve të reduktuara në planet e ardhshme të shpenzimeve është shqyrtuar veçanërisht në kuptim të kostos së pagave, duke pranuar kornizën financiare të rënë dakord me FMN-në;
- Shkaqet e detyrimeve të papaguara janë analizuar me kujdes dhe se janë marrë veprimet e duhura për t'i zvogëluar ato në nivel të OB-ve; dhe
- Është ngritur një Task Forcë e veçantë për të shqyrtuar realizimin e buxhetit dhe veprimet që mund të ndërmerren veçanërisht lidhur me procesin e prokurimit dhe planifikimit për të hequr pengesat në rritjen e nivelit të realizimit të buxhetit. Theks i veçantë duhet të vendoset mbi pengesat për realizimin efektiv të buxhetit për investime kapitale.

#### **Unë rekomandoj Kuvendin që të marrë parasysh::**

- Fokusimin në atë sa efektive është Qeveria në adresimin e rekomandimeve të dhëna dhe kërkimin e raporteve mbi progresin e bërë para se të hartohen PVF-të e BK-së për vitin 2013.

### 4 Menaxhimi Financiar

Menaxhimi i Financave Publike duhet të përfshijë një sistem gjithëpërfshirës, që përbëhet nga komponentët e ndërlidhur dhe procese të integruara në veprimet e përditshme të institucioneve publike. Kjo fillon me planifikim dhe buxhetim duke përfshirë fazën e realizimit të buxhetit dhe kontrollet e brendshme deri tek raportimi, përcjellja dhe fazat e auditimit. Bazë për realizimin e saj është Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) dhe dokumenti i politikave të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike (KBFP).

Institucionet kryesore me përgjegjësi specifike qendrore në fushën e menaxhimit financiar janë MF, MAP, dhe Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP).

Ky kapitull mbulon Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) si në nivel qendror ashtu dhe në atë lokal përfshirë këtu dhe përmbushjen e reformave që lidhen me kërkesat e raportimit të jashtëm, sistemin qendror të prokurimit, menaxhimin e pasurive, reformën në administratën publike dhe sistemin e auditimit të brendshëm.

#### 4.1 Sistemet e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MF/K)

MF/K është pjesë integrale e KBFP-së. Sistemet e MFK-së janë krijuar dhe vënë në zbatim për të marrë siguri në arritjen e objektivave të një entiteti. Kjo përfshin efektivitetin dhe efikasitetin e veprimtarisë operacionale, besueshmërinë e raportimit financiar dhe pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Si pronare e sistemeve dhe aktiviteteve të MFK-së, Ministria e Financave ka përgjegjësinë që të sigurojë zbatimin e qetë dhe efektiv të reformës në vazhdim. Ministria duhet t'i sigurojë mbështetje çdo OB-je në zbatimin praktik të kërkesave dhe pritshmërive si dhe të ofrojë trajnime dhe praktikën e duhur.

Menaxherët e lartë të organizatave individuale janë përgjegjës për zbatimin praktik të kërkesave të MFK-së brenda organizimit të tyre përkatës dhe institucioneve bazë. Ata duhet të krijojnë dhe zbatojnë MFK në të gjitha strukturat, programet, veprimtaritë, dhe proceset që sigurojnë zbatimin efektiv të kornizës ligjore, menaxhimin e duhur financiar, dhe transparencën. Duke vepruar kështu, secili menaxher duhet të zhvillojë udhëzime të brendshme për mënyrën e zbatimit dhe përshtatjes së rregullave të MFK-së të nivelit qeveritar në një ambient specifik të punës. Si pjesë e saj, politikat dhe procedurat e menaxhimit të rrezikut duhet të zhvillohen dhe të zbatohen në mënyrë efektive.

Në përgjithësi, institucionet publike nuk i kanë kushtuar rëndësinë e duhur as identifikimit dhe vlerësimit të rreziqeve<sup>4</sup> që ndërlidhen me objektivat e tyre përkatëse, as hartimit të strategjive për menaxhimin e rrezikut.

Praktikisht, vlerësimi i rreziqeve bëhet vetëm në nivel të kufizuar nga auditorët e brendshëm (edhe pse fokusi kryesor i tyre është vetëm pajtueshmëria ligjore), por pa u përqendruar në objektivat e institucionale të përcaktuara në planet strategjike.

---

<sup>4</sup> Rreziku është probabiliteti që ndonjë ngjarje apo veprim të ndikojë negativisht mbi organizatën dhe të pamundësojë përmbushjen e misionit të saj. Vlerësimi dhe menaxhimi i rrezikut definohet si proces i identifikimit dhe analizimit të rreziqeve relevante ndaj arritjes së objektivave të entitetit dhe i përcaktimit të reagimit të duhur.

Fakti se institucionet buxhetore nuk kanë arritur ende të zbatojnë plotësisht procedurat e MFK-së vërtetohet nga mangësitë e gjetura pothuajse në tërë fushat e rëndësishme të procesit buxhetor. Përveç qarkores vjetore buxhetore të nxjerrë nga MF, OB-ve ju mungojnë rregulloret apo udhëzuesit e brendshëm për përgatitjen e procesit buxhetor. Në këtë drejtim, planet strategjike, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) dhe buxheti vjetor duhet të jenë të ndërlidhura ndërmjet vete. Dobësitë janë evidente edhe tek zhvillimi i aktiviteteve të prokurimit publik, certifikimi i pagesave, raportimi, menaxhimi i personelit dhe kontrollit të pasurisë.

Qeveria qendrore dhe ajo lokale kanë treguar progres në adresimin e rekomandimeve të mëparshme të auditimit, ndonëse mbetet ende për t'u bërë në këtë të fundit. Duke bërë më shumë përpjekje në këtë drejtim do t'i ndihmoj menaxherëve të OB-ve në implementimin e MFK-së të përmirësuar dhe arritjen rezultateve të përmirësuara operacionale.

### 4.1.1 Zhvillimet aktuale

Gjatë vitit 2012, funksioni i NJQH/MFK ishte një njësi vartëse në kuadër të Departamentit të Thesarit në MF. Pozicionimi i saj ishte një sfidë për një kohë të gjatë, e cila është theksuar edhe në disa RVA tjera. Kjo njësi është përgjegjëse për koordinimin e zhvillimit dhe zbatimit të parimeve të MFK-së në të gjitha entitetet e sektorit publik.

Kjo çështje është marrë në konsideratë me rastin e ndryshimit të LMFPP-së në mes të vitit 2013. Të dy NJQH-të (MFK dhe AB) u shkri në një, me një Udhëheqës të njësisë që i raporton drejtpërdrejt Ministrit.

Kapacitetet e NJQH/MFK dhe fokusi i saj strategjik janë fusha që nevojiten të zhvillohen më tej. Progresi në vitin 2012 në këtë aspekt ishte i kufizuar.

Në RVA-në e vitit të kaluar ne rekomanduam Qeverinë të krijoj një Task Forcë speciale për zbatimin e Planit të Veprimit të MFK-së, që do të siguronte pronësi, konsistencë, dhe prioritizim si dhe do t'i raportonte drejtpërsëdrejti Ministrit të Financave. Kjo Task Forcë nuk u themelua. Shkrimi i NJQH/MFK-së me NJQH-AB-në në një departament të vetëm të sistematizuar drejtpërdrejt nën Ministrin e Financave mund të dëshmohej të jetë alternativë praktike. Ne do të përcjellim dhe analizojmë rezultatin e zbatimit të ndryshimeve në sezonin e ardhshëm të auditimit.

Vitin e kaluar, kemi raportuar se korniza ligjore e MFK-së ishte vënë në zbatim në aspektin e numrit të rregullave dhe rregulloreve të nxjerra dhe fushave të mbuluara. Projektet e mëparshme të KBFP-së kanë përkrahur MF në zhvillimin e kornizës ligjore dhe institucionale duke i ofruar stafit trajnime rreth MFK-së. Çfarë është bërë ka qenë e rëndësishme, por jo e mjaftueshme.

Në parim, OB-të kanë përshtatur sisteme të përgjithshme të menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm. Por në praktikë, ato nuk janë përshtatur rrethanave specifike në fushat individuale të politikave dhe institucionet nuk i kanë aplikuar në mënyrë efektive. Kontrollat menaxheriale në aspektin e menaxhimit të planifikimit, buxhetimit, prokurimit, projekteve, të hyrave, subvencioneve dhe pasurisë, kanë nevojë për përmirësim të mëtejshëm.

Bazuar në përvojat e fituara dhe në mënyrë që të përmbush pritshmëritë dhe kërkesat e reja nga agjenda për integrimin Evropian dhe decentralizimi i IPA-së, qasjet dhe veglat e MFK-së duhet të azhurnohen.

Projekti i ri i KBFP-së kryesisht është përqendruar në mbështetje të mëtejshme të NjQH/MFK dhe NjQH/AB, zhvillimit të MFK-së në organizatat buxhetore dhe zhvillimin e Auditorëve të Brendshëm. Projekti i ri do të punojë në zbatimin e MFK-së, si pilot projekte në tre OB. Përveç kësaj, 10 pilot auditime të brendshme do të kryhen duke mbuluar fusha të ndryshme në të njëjtën OB.

### 4.1.2 Procesi i Raportimit

Raportimi është një proces i një rëndësie të veçantë, përmes të cilës Qeveria monitoron realizimin e buxheteve të OB-ve, si dhe krijon informacionin financiar bazë për Kuvendin, për mënyrën e realizimit të buxhetit në përgjithësi.

Pjesa më e madhe e OB-ve, kanë përmbushur kërkesat ligjore lidhur me raportimin e jashtëm, duke dorëzuar kërkesat buxhetore; Raportet tremujore, nëntëmujore dhe vjetore; Raportet për obligimet e papaguara dhe planin për adresimin e rekomandimeve nga auditimi i jashtëm.

Pjesë esenciale e zhvillimit dhe zbatimit të procedurave të MFK-së është edhe vet-vlerësimi i efektivitetit të sistemeve bazuar në listat kontrolluese të prodhuara në nivel qendror. Listat e plotësuara i dorëzohen NjQH/MFK-së për rishikim. Zbatimi i këtij procesi ende nuk është në nivelin e kënaqshëm. Pak organizata kanë zbatuar atë me cilësi të duhur.

Përpos përmirësimit të vazhdueshëm në sistemin e raportimit të jashtëm, vërehet një trend pozitiv edhe te cilësia e informatave të prezantuara. Informatat kryesisht ishin të prezantuara në pajtim me kornizën e aplikueshme ligjore të nxjerrë nga MF. Por, në disa raste kemi hasur në mangësi, veçanërisht në lidhje me shpalosjet (shih kapitullin 3).

Kërkesat për raportimin vjetor të performancës janë përcaktuar nga LMFP dhe "Rregullorja Financiare 05/2011 mbi Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore". Qëllimi kryesor i raportimit vjetor është llogaridhënia menaxheriale, veçanërisht në Kuvend.

Nëpërmjet këtyre raporteve, i jepet informacion Kuvendit, palëve të tjera të interesit, medias dhe publikut të gjerë për performancën vjetore të organizatës në krahasim me rezultatet e pritura, shërbimet e ofruara, si dhe për efektivitetin e organizatës në arritjen e rezultateve. Disa OB kanë përgatitur raporte vjetore të performancës, por shumë të tjerë nuk e kanë bërë ende.

Me gjithë progresin e bërë, llojet dhe cilësia e informatave duhen të zhvillohet më tej. Kjo do të bëjë aktivitetet e Qeverisë më transparente dhe të hapura për publikun e gjerë. Kjo do t'ia mundësojë Kuvendit të kërkojë llogari nga Qeveria për realizimin e buxhetit, zbatimin e politikave dhe rezultatet e arritura. Përveç kësaj, do të përmbush kërkesat e reja të dala nga agenda e integritetit evropian.

Raportimi financiar, në lidhje me kërkesën aktuale po përmirësohet, paraqitja e raporteve vjetore ku prezantohen rezultatet financiare dhe operationale do të kontribuojë në transparencë. Kjo gjithashtu do të hap rrugën për një proces buxhetor të orientuar më shumë në rezultate dhe do të vendosë theksin në realizim dhe kosto duke mundësuar krahasimet, si një pjesë e integruar në vendosjen e prioritetëve politike dhe administrative.

### 4.1.3 Sistemi Standard i Integruar Qeveritar i Administratës Tatimore (SIGTAS)

Sa i përket tatimeve në Kosovë, procesi i menaxhimit të informatave administrohet përmes SIGTAS-it. Funksionimi i tij i duhur duhet të sigurojë menaxhim të mirë të tyre dhe transparencë të mjaftueshme në lidhje me tatimet.

Ne kemi audituar funksionimin e sistemit SIGTAS për të vlerësuar efektivitetin e tij në raport me nevojat dhe pritjet e përcaktuara nga ana e ATK-së. Është vlerësuar dizajni dhe implementimi i tij.

Përkundër disa mangësive, dizajni i sistemit i përmbush nevojat për të administruar informatat për tatimet. ATK-ja ka filluar ta përdor SIGTAS-in që nga viti 2001 me një numër të caktuar modulesh, derisa në vitin 2010 në versionin e azhurnuar janë shtuar edhe disa module të reja.

Megjithatë, pavarësisht futjes në përdorim të një versioni të ri të SIGTAS-it, zbatimi i procesit ka pasur ngecje dhe mangësi. Pas tre vitesh të implementimit të tij, disa module ende nuk janë funksionale. Mangësitë që kanë të bëjnë me dizajnin e sistemit dhe implementimin janë:

- Menaxhimi dhe raportimi i informatave në sistem;
- Vonesa në procesimin e informatave në sistem;
- Mungesa e ndërlikimeve midis aktiviteteve brenda për brenda sistemit; dhe
- Mungesë e harmonizimit të informatave të sistemit me një vegël tjetër (Share point) që përdoret nga ATK.

Mangësitë e lartpërmendura duhet të adresohen para se sistemi të konsiderohet një vegël plotësisht funksionale duke mundësuar menaxhim më efikas të informatave për tatimet dhe të hyrat e mbledhura.

### 4.1.4 Prokurimi

Mbi 15% e Bruto Produktit Vendor ose mbi 50% e buxhetit të BK-së është shpenzuar në prokurime për vitin 2012. Shpenzimet publike kanë një ndikim mjaft të madh në zhvillimin e ekonomisë vendore. Prokurimi efektiv luan rol kyç në zhvillimin e tregut privat.

Në përgjithësi, sistemi i prokurimit ka vazhduar të forcohet për sa i përket kornizës ligjore dhe rolet mes aktorëve qendrorë janë qartësuar më shumë<sup>5</sup>.

Ndryshimet e fundit të Ligjit për Prokurim Publik dhe legjisllacionit dytësor kanë filluar të kuptohen dhe zbatohen më mirë. Edhe pse e themeluar në fund të vitit 2011, Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) vetëm tani është duke tentuar të filloj me dy prokurime të centralizuara në nivelin qendror. Mbetet të shihet nëse kjo do rezultojë me sukses.

Prokurimi gjatë vitit 2012 ka shënuar progres në disa fusha, e në disa tjera ende ka sfida të rëndësishme. Progresi mund të identifikohet nga:

- Zvogëlimi i përdorimit të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontrata;
- Ngritje e përdorimit të kontratave kornizë; dhe
- Vazhdimi i trajnimeve në nivelin e avancuar të prokurimit të 499 kandidatëve. Po ashtu është bërë edhe trajnimi 5 javor i trajnerëve në prokurimin publik i 26 pjesëmarrësve.

---

<sup>5</sup> TInstitucionet qendrore të prokurimit siç janë KRPP, OSHP kanë lëshuar vazhdimisht Udhëzime Administrative dhe rregullore pune. Gjatë vitit, KRPP ka lëshuar UA 01/2012 për Planifikimin e prokurimit dhe informacione shtesë për UA 02/2012 që ka të bëjë me qartësimin e disa dispozitave të LPP-së; dhe OSHP ka aprovuar rregulloren e saj të punës. Të gjitha këto ndikojnë në qartësimin e mëtejshëm të procedurave të prokurimit.

Disa çështje të prokurimit akoma mbesin sfidë për qeverinë dhe Autoritetet Kontraktuese. Konsiderojmë se sfidat e rëndësishme në prokurim janë prokurimi elektronik dhe prokurimet e centralizuara.

Ne kemi vërejtur se AK-të kanë mangësi në kryerjen e prokurimit, që nga iniciimi i procesit të prokurimeve e deri te implementimi i plotë i kontratave dhe auditimet tona të menaxhimit të prokurimit kanë nxjerrë në pah nëse rregullat e prokurimit nuk janë respektuar. Mangësitë më të shpeshta të identifikuara në të gjitha auditimet individuale kanë të bëjnë me:

- Mungesën e Deklaratës së Nevojave dhe Disponueshmërisë së Mjeteve si dhe raste kur zotimi i mjeteve ishte i pamjaftueshëm;
- Ndarja e tenderëve për blerjen e artikujve identik për të shmangur procedurat e prokurimit;
- Hartim i specifikave teknike në kundërshtim me rregullat e prokurimit;
- Lidhja e kontratave me sigurimin e ekzekutimit që nuk e mbulon shumën obligative ose raste kur ajo kishte skaduar;
- Lidhja e kontratës me Operatorë Ekonomik (OE) të papërgjegjshëm dhe mos informimi i OE-ve të eliminuar;
- Vonesa në formimin e komisionit të vlerësimit;
- Tejkalimi i limitit për punë shtesë;
- Mungesa e planeve për menaxhim të kontratave dhe emërimit të menaxherit të prokurimit;
- Furnizim jashtë kontratës dhe në kundërshtim me specifikat; dhe
- Vonesa në realizimin e projekteve sipas afateve të parapara me kontratë.

Korniza e re ligjore ka plotësuar disa hapësira të cilat kishin ekzistuar si dhe është ngritur efikasiteti i trajtimit të kërkesave, trajnimeve të stafit, ankesave dhe përgjigjeve të kërkuara nga ana e institucioneve të prokurimit.

Përpjekjet aktuale për fillimin e prokurimeve të centralizuara nga ana e AQP janë inkurajuese. Në raportin e KRPP-së thuhet se sistemi i prokurimit për çdo vit po shënon progres dhe po bëhet më transparent. Megjithatë, raportet tona individuale vënë në pah se zbatimi i kornizës ligjore të prokurimit ende nuk është në nivelin e kënaqshëm me shumë shkelje dhe parregullsi të identifikuara.

#### **4.1.5 Menaxhimi i Automjeteve Qeveritare**

Kategori e rëndësishme e pasurisë kapitale janë edhe automjetet qeveritare dhe Udhëzimi Administrativ nr. 03/2008 rregullon përdorimin e këtyre automjeteve. MAP ka themeluar Njësine specifike që monitoron se si përdoren automjetet qeveritare dhe OB-të duhet t'i dorëzojnë kësaj njësie raportin mujor mbi përdorimin dhe menaxhimin e automjeteve. Më tutje, ajo harton raporte mujore përmbledhëse.

Kjo njësi nuk kishte funksionuar si duhet. Nuk disponon me regjistra të saktë për numrin e përgjithshëm të automjeteve të qeverisë e as shënime të plota dhe të sakta për përdorimin e tyre. Kjo ngase institucionet përkatëse të qeverisë nuk dorëzonin raporte të rregullta mujore dhe në mungesë të veprimit për të ndryshuar situatën. Me qëllim të përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësisë, kjo njësi është riorganizuar në fillim të vitit 2013.

Edhe përkundër përpjekjeve të vazhdueshme për të përmirësuar funksionimin e sistemit, edhe me tutje ai nuk është efikas. Mangësitë e theksuara më lartë e pamundësojnë aplikimin e menaxhimit efektiv dhe kontrollit mbi veturat, si dhe shmangien nga humbjet financiare.

#### 4.1.6 Reforma në Shërbimin Civil dhe Kompensimet

Një prej objektivave të Reformës së Administratës Publike të Kosovës është edhe menaxhimi më i mirë dhe zhvillimi i Burimeve Njerëzore. Synimi është të krijohet një shërbim civil profesional, të paanshëm, të pavarur dhe të bazuar në meritë, të orientuar kah shërbimi ndaj qytetarëve dhe bizneseve.

Strategjia e trajnimit të nëpunësve civil të administratës publike (2011-2013) është komponentë e rëndësishme e kësaj Reforme përmes së cilës synohet krijimi i një administrate publike efektive dhe profesionale.

Zbatimi i sistemit të ri të pagave do të mundësonte unifikimin dhe harmonizimin e pagave për pozitat e nivelit të njëjtë të përgjegjësisë. Megjithatë, Rregullorja nr. 05/2012 mbi pozitat e punës nuk është implementuar, duke vonuar kështu paraqitjen e sistemit të ri të pagave.

Progres është shënuar në krijimin e një baze ligjore adekuate dhe gjithëpërfshirëse. Janë finalizuar disa akte nënligjore që rrjedhin nga Ligji për Shërbimin Civil (LSHC), dhe Ligji për Pagat e Nëpunësve Civil (LPNC). Këto krijojnë parakushte për zbatimin adekuat të LSHC dhe LPNC e njëkohësisht edhe për progresin e reformave në përgjithësi.

Sistemi i pagave menaxhohet nga MAP. Regjistri Qendror i Nëpunësve Civil është sistem që ndërvepron me bazën e të dhënave të sistemit të pagave, si dhe me bazën e të dhënave të sigurimit pensional të detyrueshëm. Kërkohej që OB-të të krijojnë edhe dosjen elektronike për të punësuarit, por nuk kanë arritur që plotësisht të përmbushin kërkesat. Kjo e vështirëson mirëmbajtjen dhe azhurnimin e duhur të dosjeve, përfshirë këtu edhe menaxhimin e personelit në përgjithësi.

Numri i përgjithshëm i punëtorëve në sektorin publik i aprovuar me Ligjin e rishikuar të buxhetit për vitin 2012 ishte 78,954, ndërsa sipas listave të pagave (Payroll-MAP) numri aktual i të punësuarve publik në muajin e fundit të vitit ishte 77,780. Prej tyre, 22,759 të punësuar i takojnë shërbimit civil.

Në tabelën në vijim janë prezantuar shpenzimet vjetore të pagave të rregullta dhe pagave retroaktive sipas Payroll-it për vitin 2012 dhe 2011

**Tabela 9: Shpenzimet vjetore të pagave dhe mëditjeve**

*në euro (€)*

Përshkrimi	Pagat e rregullta 2012	Pagat retroaktive 2012	Pagat totale 2012	Pagat totale 2011
Pagat neto përmes listës së pagave	347,135,732	1,280,079	48,416,031	330,245,119
Tatimi i ndalur në burim në paga	18,281,527	56,856	18,338,383	16,909,809
Kontributi pensional nga punëtori	19,265,665	69,610	19,335,275	18,302,812
Kontrib. pensional nga punëdhënësi	19,265,665	69,610	19,335,275	18,302,812
Pagesa për sindikatë	1,209,922	-	1,209,922	1,152,675
<b>Totali</b>	<b>405,158,732</b>	<b>1,476,155</b>	<b>406,634,886</b>	<b>384,913,227</b>

Shpenzimet për Paga dhe Mëditje për vitin 2012 ishin 409,245,000€ sipas PVF-ve të BK-së. Nga Buxheti i Kosovës janë paguar 407,706,000€ derisa 1,539,000€ nga grantet e përcaktuara të donatorëve.

Diferenca midis pagesave të bëra përmes sistemit të pagave (406,634,886€) dhe pagesave nga buxheti i Kosovës, të prezantuara në PVF-të e KB-së (407,706,000€) është 1,071,114€. Dallimi është për shkak të faktit se pagat janë paguar edhe përmes SIMFK. Pagesa e pagave përmes SIMFK dhe shmangja e sistemit të pagave tregon mungesën e mekanizmave dhe kontrolleve të duhura në këtë fushë. Në të njëjtën kohë shpenzimet totale për kompenzimet nuk janë transparente sa duhet.

Për vitin 2012, paga mesatare mujore në nivel të përgjithshëm në administratën publike ishte 448€. Paga mesatare mujore ndryshon ndërmjet OB-ve. Nivel më i ulët i pagës mesatare mujore paraqitet tek niveli lokal/komunat.

Vonesat në aplikimin e sistematizimit dhe klasifikimit të vendeve të punës në shërbimin civil, pengojnë zhvillimin e kompenzimeve të ndershme, të kuptueshme dhe transparente. Në të njëjtën kohë, pengon futjen e stimulit të bazuar në rezultate.

Menaxhimi dhe kontrollet në këtë fushë nuk janë edhe aq efikase. Kjo është vërejtur nga çështjet e ngritura në raportet individuale të auditimit. Kryesisht mangësitë janë hasur gjatë:

- Procedurave të rekrutimit;
- Pagesave të pagave dhe llogaritjeve të gabuara;
- Pagesave të pagave shtesë pa u arsyetuar dhe dëshmuar si duhet;
- Pagesa e pagave nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve;
- Llogaritjes së pagave për pushimet e lehonisë;
- Përpilimit të kontratave, e në disa raste mos aplikimit të kontratave;
- Titujt e pozitave sipas kontratave nuk ishin në harmoni me titujt në listën e pagave;
- Ushtrimit të pozitave me Ushtrues Detyre përtej afatit kohor ligjor; si dhe
- Përgatitjes dhe mirëmbajtjes së dosjeve të personelit.

### 4.1.7 Menaxhimi i mbeturinave mjekësore

Menaxhimi i duhur i mbeturinave medicinale është i rëndësishëm për një sistem të shëndoshë shëndetësor, mbrojtje të shëndetit publik dhe mjedisit. Përkundër ekzistimit të një kornize ligjore dhe procedurave të qartësuara dhe përgjegjësitë, menaxhimi i këtij lloji të mbeturinave, në shumicën e rasteve, devijon nga standardet e vendosura dhe është ende larg objektivave.

Pothuajse të gjitha aktivitetet, qoftë ndarja, grumbullimi, transportimi ose asgjësimi përfundimtar, janë kryer në baza ad-hoc. Në parim, mbeturinat medicinale nuk ndahen nga mbeturinat e përgjithshme. Qasja joadekuate e institucioneve shëndetësore (ISH) mbi çështjen ka përcaktuar rrjedhën e tërë procesit.

Në kuptim të inspektimit, Inspektorati Mjedisit (MMPH) nuk ka staf të mjaftueshëm që në mënyrë adekuate të monitorojë të gjitha ISH-të. Procesi i menaxhimit kërkon mobilizim të tërë mekanizmit, duke siguruar se i gjithë procesi është funksional dhe efektiv.

Përfundimisht, duhet të merren masa të menjëhershme nga palët respektive për të rritur ndërgjegjësimin e stafit të përfshirë lidhur me rëndësinë e menaxhimit të duhur të mbeturinave, për të reduktuar ndikimin në shëndetin publik dhe mjedis.

### 4.2 Sistemi i Auditimit të brendshëm

#### Auditimi i brendshëm në sektorin publik

Zhvillimi i auditimit të brendshëm në sektorin publik po shkon në drejtimin e duhur. Në të njëjtën kohë, sfidat e reja në sektorin publik kanë ndikuar që të rriten pritshmëritë e palëve të interesit nga auditimi i brendshëm.

Ofrimi i këshillave mbi kontrollat dhe proceset si dhe ofrimi i rekomandimeve para zbatimit të tyre mund të jetë mbështetje shumë e rëndësishme për Menaxhmentin në vendimet e tyre. Kjo është e një rëndësie të madhe tani që Administrata Publike është në procese reformuese. Një Auditim i brendshëm me përvojë dhe njohuri mbi kontrollat, qeverisjen dhe rrezikun, mund të përdoret si lehtësues në aktivitetet e ndryshme të Menaxhmentit ose të sigurojë këshilla mbi ndonjë rrezik të veçantë dhe çështjet e kontrollit.

Përgjegjësitë e NJQH/AB nuk i përfshijnë Ndërmarrjet Publike (NP-të). Zhvillimi i auditimit të brendshëm në këto organizata, të cilat ofrojnë shërbime shumë të rëndësishme tek qytetarët, është një hallkë që i mungon sistemit aktual. Projekte tjera të donatorëve janë të përfshira në këtë fushë. Mbetet të prezantohet një qasje e qëndrueshme për zhvillimin e profesionit të Auditimit të Brendshëm (në përgjithësi dhe në sektorin publik).

Shifrat në këtë kapitull ndërlidhen vetëm me auditorët e brendshëm brenda OB-ve dhe nuk përfshijnë rreth 30 auditorë të brendshëm në kuadër të NP-ve.

#### Cilësia e planifikimit

Planet e auditimit të brendshëm jo gjithmonë drejtohen nga analiza të forta mbi nevojat e organizatës. Rreth 18% e planeve të rishikuara të auditimit të brendshëm nuk i kanë identifikuar fushat me rrezik të madh. Kjo është pjesërisht për shkak të mungesës së një kornize të duhur të menaxhimit të rrezikut në OB. Auditorët e brendshëm ende mbështeten në vlerësimin e tyre të fushave me rrezik të lartë dhe gjykimin e tyre profesional.

Në përgjithësi, detyrat e auditimit të brendshëm janë planifikuar për të ofruar siguri përmes testimit të pajtueshmërisë dhe për të përfshirë, në një nivel shumë të vogël, çështjet rreth efikasitetit dhe efektivitetit, punën rreth këshillimit dhe konsultimit.

Për sa i përket fokusit të auditimit të brendshëm në periudhën aktuale, situata është e ngjashme me atë në vitin e kaluar, ku rreth 21% e njësive të auditimit të brendshëm i përqendruan aktivitetet e tyre më shumë në periudhat e kaluara sesa në vitin aktual.

Shumica e NJAB-ve kanë kryer më shumë auditime këtë vit në krahasim me vitin e kaluar.

Disa NJAB kanë bërë aktivitete shtesë të auditimit me kërkesë të Menaxhmentit.

Cilësia e raporteve të auditimit të brendshëm është duke u përmirësuar por ende ka nevojë për përmirësime.

### **Aftësitë**

Aktualisht 32 auditorë të brendshëm duke përfshirë NJQH / AB janë të certifikuar, që përbëjnë rreth 24% të auditorëve të brendshëm në OB. Grupi i dytë i auditorëve të brendshëm kanë filluar skemën e certifikimit në prill të vitit 2013. Megjithatë, ky certifikim duhet konsiderohet si standard minimal i aftësive dhe njohurive të nevojshme për praktikën e auditimit të brendshëm. Nevojiten trajnime të vazhdueshme për të mirëmbajtur dhe zhvilluar profesionalizmin.

Aktualisht, trajnimi për certifikim ofrohet nga NJQH/AB dhe stafi i auditimit të brendshëm. Vet skema përfshin vetëm njohuri teorike dhe nuk lidhet me ndonjë përvojë praktike. Megjithatë, përveç kësaj, në kuadër të projektit të ri të KBFP-së, NJQH/AB ka filluar të zhvilloj programin e ri të ZHVP-së për auditorët e brendshëm.

Funksioni i auditimit të brendshëm ende ballafaqohet me kufizime në burime dhe ekspertizë. Shërbimet e Auditimit të Brendshëm në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe menaxhimit të rrezikut të informacionit mbesin ende të pazhvilluara.

### **Burimet**

Gjatë vitit 2012, kanë punuar 133 auditorë të brendshëm dhe rreth 1,000.000€ janë shpenzuar.

Për shkak të kufizimeve buxhetore, Njësitë e Auditimit të Brendshëm ende nuk janë të pajisur me numrin e nevojshëm të auditorëve të brendshëm. Prandaj ato sfidohen për të përdorur burimet ekzistuese në mënyrën më efikase duke u fokusuar tek fushat me rrezik të lartë, dhe duke treguar kështu se ata mund të bëjnë më shumë me burimet ekzistuese ose me më pak burime.

Ministria e Diasporës, shtatë komuna dhe një institucion i pavarur nuk i kanë krijuar ende Njësitë e Auditimit të Brendshëm.

MF ende ofron shërbime të auditimit të brendshëm për institucionet e pavarura. Në vitin 2012, filluan diskutimet bazuar në rekomandimet e dhëna në RVA-të e mëhershme për krijimin e një shërbimi të auditimit të brendshëm në Kuvend për të mbështetur Institucionet e Pavarura më të vogla. Rezultatet e kësaj ende mbeten për tu parë.

### **Komitetet e Auditimit (KA-të)**

KA-të ende nuk ofrojnë mbështetjen që është dashur ta ofrojnë për bordet, kuvendet komunale, ministrat dhe menaxhmentin ekzekutiv.

Krahasuar me vitin e kaluar, numri i KA-ve është rritur, por ende diku rreth 15% prej tyre nuk ishin funksionale gjatë vitit. Rreth 20% e institucioneve, kryesisht komuna, akoma nuk kanë themeluar KA.

Që nga dhjetori i vitit 2012, pagesa e anëtarëve të KA-ve është rregulluar me Rregulloren nr. 34/2012 të nxjerrë nga Qeveria. Mbetet për t'u parë nëse kjo do të sigurojë OB-ve, një KA më funksionale në të ardhmen.

### 4.3 Konkluzionet e përgjithshme

Qeveria ka bërë progres në drejtim të përcaktimit dhe qartësimin të kornizës legislative dhe institucionale për MFP, duke ofruar një platformë të përshtatshme për zhvillimin e vazhdueshëm. Megjithatë, OB-të nuk e implementojnë kornizën rregullative në tërësi. Kjo ka nevojë të adresohet së bashku me veprimet për zhvillimet e mëtejshme në kornizë.

Menaxherët e OB-ve nuk kanë krijuar ende elemente të nevojshme për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm të kontrollit të brendshëm. Ky mjedis duhet të zhvillohet më tej. Kjo përfshin aktivitetet monitoruese të ndërmarra nga menaxhmenti i lartë dhe kontrollet e nivelit më të ulët operativ.

Kontrollet më të mira të mjedisit do të mbështesin performancën e përmirësuar operacionale, cilësinë e shërbimit dhe vlerën për para.

Institucionet kryesore me përgjegjësi qendrore duhet të zhvillojnë edhe më tej parakushte, qasje dhe mjete të mira për të mbështetur implementimin efektiv të kornizës ligjore.

### 4.4 Rekomandimet

#### ***Unë rekomandoj Qeverinë të sigurojë se:***

- Kërkesat e MFK-së zbatohen në praktikë nga organizatat e sektorit publik duke u bazuar mbi parimet e delegimit të përgjegjësisë dhe llogaridhënies për objektivat dhe rezultatet financiare dhe operative;
- Secili menaxher është proaktiv në zhvillimin e udhëzuesit të brendshëm që ka të bëjë me MFK-në, në mënyrë që të përshtatin rregullat e Qeverisë qendrore në një ambient specifik;
- MF krijon një kornizë model që do të shërbejë si mjet udhëzues për secilin menaxher. Më tutje, zbatimin e tij efektiv duhet të jetë nën kontroll të vazhdueshëm nga menaxhmenti. Kontributi i auditimit të jashtëm dhe të brendshëm duhet të përdoret si bazë për zhvillimin e mëtejshëm të MFK-së;
- Përhapja e praktikave të mira dhe përvoja e fituar nga pilot projektet e KBFP-së tek organizatat tjera është prioritet në një perspektivë strategjike;
- OB-të individuale zhvillojnë dhe zbatojnë një qasje efektive të menaxhimit të rrezikut në lidhje me objektivat organizative dhe misionin e tij. Kjo të përdoret si bazë për forcimin dhe zhvillimin e një mjedisi të përshtatshëm dhe efektiv të kontrollit;
- Analizohen kërkesat për raportimin e rezultateve dhe indikatorët e kostos zhvillohen si fushë me prioritet në kuadër të reformës së MFP-së. Duke bërë këtë, duhet të analizohet mundësia për të bashkuar këtë raportim me raportimin financiar në PVF;
- Ministri i Financave inkurajon zhvillimin e planit të veprimit për të siguruar implementimin e plotë të SIGTAS-it;
- Korniza ligjore për administratë civile zbatohet në tërësi. Kjo do të përshpejtojë dhe rris progresin në reformën e administratës publike në përgjithësi. Procesi i krijimit të një sistemi të ri të pagave të prioritetizohet, procesi i klasifikimit të vendeve të punës të finalizohet, dhe procesi i rekrutimit të bazohet në meritë dhe të kryhet në një mënyrë të hapur;
- Burimet e auditimit të brendshëm përdoren nga secili menaxher në mënyrë që të maksimizohet

efektiviteti i qasjes së auditimit të bazuar në rrezik. Përveç skemës bazë të certifikimit, të hartohet një program për Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional (ZHVP) për nevojat dhe prioritetet e auditorëve të brendshëm. Ndarja e përvojave të auditimit të brendshëm do të rriste efektivitetin e auditimit të brendshëm;

- Është inicuar një studim si të gjendet një zgjidhje e qëndrueshme e certifikimit për profesionin e Auditimit të Brendshëm në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të brendshëm; dhe
- Rotacioni i stafit të auditorëve të brendshëm ose bashkë-kombinimi i shërbimeve mund të merret në konsideratë me qëllim që të fitohet përvoja dhe njohuria e nevojshme për të rritur efektivitetin e njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik. Përveç kësaj, duhet të bëhet një vlerësim strukturor dhe formal i performancës së Komiteteve të Auditimit.

### ***Unë rekomandoj Kuvendin që të marrë parasysh:***

- Lehtësimin për futje të shpejtë në përdorim të prokurimit elektronik i cili do të rrisë transparencën dhe redukton procedurat burokratike;
- Nxitjen e prokurimeve të centralizuara nga Qeveria në mënyrë që të sigurojë ekonomizimin dhe vlerën më të mirë për paratë e shpenzuara;
- Gjetjen e një zgjidhje të qëndrueshme, kur është fjala për kryerjen e shërbimeve të auditimit të brendshëm në institucionet e pavarura të vogla që janë drejtpërdrejt përgjegjës para Kuvendit, e që do të nxisë pavarësinë dhe llogaridhënien; dhe
- Përcjelljen nga afër të masave të marra në kuadër të autoriteteve kompetente dhe institucioneve shëndetësore për adresimin e rekomandimeve të dhëna në lidhje me menaxhimin e mbeturinave medicinale në mënyrë që të tejkalohen rreziqet për shëndetin publik dhe mjedisin.

## 5 Realizimi i buxhetit në Sektorin Publik

### 5.1 Autoritetet Qendrore

Të gjitha 22 Autoritetet Qendrore<sup>6</sup> janë mbuluar me auditim të rregullsisë. Ato rezultuan në 14 Opinione të pakualifikuara dhe 10 Opinione të pakualifikuara me theksim të çështjes.

**Tabela: 10 Opinionet e auditimit gjatë tre viteve të fundit**

Opinionet e Auditimit	2012	2011	2010
Pakualifikuar	14	13	10
Pakualifikuar me theksim të çështjes	10	11	12
I kualifikuar			1
Kualifikuar me theksim të çështjes			
I kundërt			1
<b>Totali:</b>	<b>24<sup>7</sup></b>	<b>24</b>	<b>24</b>

PVF-të prezantonin një gjendje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale dhe ishin të përgatitura në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullës Financiare 07/2011 mbi raportimin vjetor. Megjithatë, rastet me theksim të çështjes kryesisht ndërlidheshin me çështje për cilësinë e informatave, të cilat pritet të përmirësohen në vitin vijues.

Në përgjithësi, janë vërejtur përmirësime nga periudhat e mëhershme raportuese në sistemin e raportimit, edhe te vendosja, zhvillimi dhe zbatimi i kontrolleve në përgjithësi.

Performanca e përgjithshme e tyre buxhetore ishte e mirë, me një realizim buxheti prej 94%<sup>8</sup>.

Me gjithë performancën e mirë financiare dhe operative, ekzistojnë një numër sfidash me të cilat AQ-të vazhdojnë të përballen dhe të cilat janë prezantuar më poshtë.

#### Sfidat

Numri i rekomandimeve të adresuara nga këto institucione vazhdimisht përmirësohet. Të gjitha AQ-të kanë nxjerrë plane veprimi për adresimin e rekomandimeve të vitit 2011. Nga 204 rekomandime të dhëna, 160 janë adresuar (65 plotësisht dhe 95 në proces të adresimit), ndërsa 44 kanë mbetur të pa adresuara. Mos adresimi i plotë i rekomandimeve ka rezultuar në përsëritjen e mangësive nga viti i kaluar.

<sup>6</sup> 22 AQ përfshijnë: Kuvendin, Zyrën e Presidentit, Zyrën e Kryeministrit si dhe 19 Ministri. Megjithatë, ishin 24 opinione për AQ, pasi opinione janë dhënë ndaras për dy agjenci në varësi të Ministrisë së Financave, përkatësisht Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës.

<sup>7</sup> Dogana dhe ATK janë përfshirë në auditim

<sup>8</sup> Edhe pse pjesa më e madhe e tyre kishin një realizim shumë të mirë të buxhetit, përjashtim nga kjo bëjnë Zyra e Presidentit me realizim 55%, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë 61% dhe Ministria e Financave 76%.

Menaxhimi i të hyrave po ashtu është përcjellë me mangësi të ndryshme. Të hyrat ishin regjistruar dhe raportuar më vonësë, si dhe nuk kishte harmonizime të plota në mes të regjistrave dhe dokumenteve burimore. Ndërsa në raste të caktuara, realizimi i të hyrave nuk është bërë në përputhje me tarifrat e përcaktuara.

Prokurimi vazhdon të mbetet fusha më sfiduese gjatë vitit 2012. Përpos dobësive në fazën e planifikimit dhe kontraktimit, dobësitë janë evidente edhe te ekzekutimi i kontratave. Komisionet e vlerësimit të tenderëve nuk kishin treguar shkallë mjaft të lartë përgjegjësisë dhe objektivitetit në punën e tyre, që kishte shkaktuar lidhjen e kontratave në mungesë të ofertave të përgjegjshme, ose në disa raste lidhjen e kontratave me OE të papërgjegjshëm. Përdorimi i procedurave të kuotimit të çmimeve edhe këtë vit ishte tejkaluar me qëllim shmangien nga procedurat e hapura të prokurimit. Në shumë raste janë përdorur disa herë brenda vitit për mallra dhe shërbime të njëjta. Gjatë ekzekutimit, kishte raste kur janë pranuar mallra dhe shërbime të cilat nuk ishin të parapara me kontratë. Mangësitë e tilla janë rrjedhojë e kontrolleve të dobëta në monitorimin e kontratave.

Po ashtu, kemi gjetur se procesi i certifikimit në AQ nuk ishte funksional sa duhet. Kishte pagesa të cilat nuk ishin bërë në pajtim me kontraktimet, si dhe pagesa pa dokumentacion të kompletuar si duhet. Menaxhimi i avanceve po ashtu ishte një dobësi pasi kishte shumë raste kur ato ishin mbyllur me vonësë.

Edhe menaxhimi i Burimeve Njerëzore ballafaqohet me probleme, kishte rekrutime që nuk përmbushnin kriteret e përcaktuara në konkurs. Një prej problemeve të vërejtura ishte se një numër i madh i pozitave vazhdon të mbulohet me ushtrues detyre, përtej periudhës së lejuar me ligj që mund të shpie në performancë dhe cilësi të dobët të shërbimeve të kryera. Kompensimet për stafin për punë jashtë orarit në mungesë të dëshmime mbështetëse i shkakton barrë financiare buxhetit.

Monitorimi mbi shpenzimet e subvencioneve dhe transfereve kishte munguar pothuajse plotësisht. Në shumë raste, përfituesit e këtyre subvencioneve ose nuk kishin dorëzuar raporte lidhur me shpenzimet, ose raportet e tyre ishin shumë të mangëta që rrezikon mjetet e shpenzuara të mos arrijnë qëllimin e caktuar.

Përmirësime të dukshme janë vërejtur te menaxhimi i pasurive në raport me vitin e kaluar. Brenda këtij viti, regjistrat kontabël janë kompletuar në disa institucione. Megjithatë, në disa prej tyre edhe më tutje vërehen parregullsi në regjistrimin dhe raportimin e tyre.

Për shkak të ndikimit të madh financiar, ne kemi mbuluar edhe menaxhimin e automjeteve. Kemi gjetur raste kur automjetet janë shfrytëzuar 24 orë pa aprovime, si dhe procedurat për përdorimin e tyre janë anashkaluar. Më brengosëse ishte menaxhimi i dobët i veturave të Policisë ku afro 1,400 automjete nuk kishin kontrolle të duhura. Një numër i madh i automjeteve presin një kohë të gjatë për servisim<sup>9</sup>, e që është shqetësuese marrë parasysh jetën e kufizuar të automjeteve të Policisë.

Te obligimet e papaguara është një situatë më e mirë, pasi që pjesa më e madhe e institucioneve kishin arritur t'i menaxhojnë mirë ato. Megjithëse, disa prej tyre nuk kishin raportim të drejtë të obligimeve që mund të shpie në ekzekutimin e pagesave të dyfishta ose mos pagesën e obligimeve ndaj kontraktuesve.

---

<sup>9</sup> Në auditimin e Policisë kemi gjetur se 173 automjete ishin duke pritur për servisim për një periudhë të gjatë, disa prej të cilave edhe nga viti 2009

Sfidë e veçantë mbetet linja e llogaridhënies ndërmjet ministrive dhe agjencive autonome që operojnë në kuadër të tyre. Në veçanti, nuk ekziston një ndarje e qartë e detyrave në mes të Sekretarit të Përgjithshëm (SP) të Ministrisë si një institucion mëmë dhe drejtorit të Agjencisë autonome. SP-të të Ministrive mëmë shpesh janë anashkaluar, derisa në agjenci ekzistojnë ndërhyrje të drejtpërdrejta politike. Për shkak të kësaj, SP-të kanë shpesh probleme të drejtojnë ndryshimet dhe masat e kërkuara në një agjenci të tillë. Përveç kësaj, këto agjenci nuk janë të obliguara të prodhojnë dhe publikojnë PVF. Në të njëjtën kohë, një numër i tyre ka nevojë të prodhojë informata financiare dhe operacionale vjetore të jashtme për shkak të agjendës evropiane. Regjimi i tanishëm nuk mund të konsiderohet mjaft transparent.

AQ-të kishin treguar progres kryesisht në fushën e raportimit, përfshirë raportimin e brendshëm dhe të jashtëm. PVF-të e tyre paraqesin një gjendje të saktë dhe të drejtë në të gjitha aspektet financiare. Mangësitë ndërlidhen kryesisht me shpalosjet e informatave të caktuara, të cilat nuk kanë ndikim material në nivel të përgjithshëm të PVF-ve.

AQ-të, në përgjithësi, kishin ndërtuar mjedis relativisht të mirë të kontrollit, mirëpo ne kemi vërejtur mangësi në aktivitetet e kontrollit dhe monitorim si dhe mungon vlerësimi i mirë i rrezikut. Funkcionimi me një numër të madh ushtruesish detyre tregon se ende nuk është krijuar një sistem i qëndrueshëm i sistemit të kontrollit të brendshëm në të cilin llogaridhënia funksionon në mënyrë efektive.

Te menaxhimi i shpenzimeve, kontrollet menaxheriale nuk janë të mjaftueshme, në veçanti llogaridhënia dhe përgjegjësia e brendshme menaxheriale nuk ishin të zhvilluara sa duhet. Vlen të përmendet, trajtimi i prokurimeve për shkak të rëndësisë së veçantë. Menaxhimi dhe monitorimi i fondeve të dhëna si subvencione ishte i dobët, me rrezik që mjetet e tilla të keqpërdoren. Funkzioni i certifikimit kishte dështuar në detyrën e tij duke certifikuar këto pagesa përkundër problemeve të prezantuara.

Prandaj, është e rëndësishme që autoritetet qendrore të vendosin tonin kur është fjala për vendimet e duhura (të mençura) afariste dhe maturi në shpenzim marrë parasysh situatën me buxhet të mangët.

Bazuar në këtë, gjatë vitit 2013, Qeveria gjithë fokusin duhet ta drejtojë në fushat në të cilat vazhdon të ketë mangësi dhe të monitorojë adresimin e këtyre çështjeve nga AQ-të.

Qeveria duhet të qartësojë edhe më shumë linjat e komunikimit të jashtëm dhe të nxjerrë një kërkesë për agjencitë si për: policinë, Administratën Tatimore, Doganat dhe entin statistikor, që të prodhojnë PVF dhe të funksionalizojnë auditimin vjetor statutor. Këto katër agjenci mund të konsiderohen si pilotë në paraqitjen e raportimit vjetor të jashtëm ku informatat financiare dhe operacionale shkrihen në PVF, për shkak të rëndësisë së tyre për taksapaguesit.

### **Rekomandimet**

#### ***Unë rekomandoj Qeverinë të sigurojë se AQ-të:***

- Obligohen të kryejnë vetë-vlerësimet e MFK-së dhe t'i raportojnë ato në MF brenda 6 muajve;
- Rishikojnë boshllëqet në rregullat përkatëse dhe udhëzimet e brendshme të MFK-së, duke marrë parasysh nevojat specifike të AQ-ve individuale duke siguruar kështu një ndarje të qartë të detyrave dhe mekanizma të duhur të llogaridhënies; dhe
- Kanë shqyrtuar më kujdes të gjitha rekomandimet e dala nga auditimet (të brendshme dhe të jashtme) dhe të përgatisin një plan të rishikuar për adresimin e tyre, i cili në fokus fillestar përfshin rekomandimet e një rëndësie më të madhe

## Unë rekomandoj Kuvendin që të marrë parasysh:

- Monitorimin më të afërt se si Qeveria adreson çështjet e theksuara më lartë përmes komisioneve të saja përkatëse.

## 5.2 Institucionet e Pavarura (IP-të)

Ne kemi kryer auditimin e rregullsisë për PVF në 26<sup>10</sup> Institucione të Pavarura dhe kemi dhënë 24 Opinione të Pakualifikuara (gjashtë me theksim të çështjes), tre Opinione të kualifikuara (një me theksim të çështjes). Tabela më poshtë tregon se pos progresit të bërë në vitin 2011 krahasuar me 2010, ne kemi vërejtur mungesë të progresit në raportim të jashtëm për vitin 2012.

**Tabela 11: Opinionet e auditimit të dhëna gjatë tre viteve të fundit**

Opinionet e auditimit	Viti 2012	Viti 2011	Viti 2010
Të pakualifikuara	18	18	4
Të pakualifikuara me theksim të çështjeve	6	7	10
Të Kualifikuara	2	1	1
Të kualifikuara me theksim të çështjeve	1		
I kundërt			2
<b>Gjithsej:</b>	<b>27</b>	<b>26</b>	<b>17</b>

Tabela më lartë tregon që Pasqyrat Vjetore Financiare të Institucioneve të Pavarura për vitin 2012, kanë prezantuar një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale. Janë dhënë tri opinione të kualifikuara për shkak të pagesave jo të rregullta për kompensime.

Po ashtu, kemi identifikuar mangësitë në cilësinë e informatave të cilat kryesisht kishin të bënin me mungesën e shpalosjeve adekuata lidhur me pasuritë në pronësi të IP-ve.

Shumica e Institucioneve të Pavarura vazhdojnë të tregojnë përkushtimin e tyre për të përmirësuar menaxhimin e financave publike, duke vendosur, zhvilluar dhe zbatuar kontrollet në përgjithësi. Të gjithë IP-të kanë hartuar planet e veprimit për implementimin e rekomandimeve tona dhe shkalla e adresimit të këtyre rekomandimeve ishte në nivel të kënaqshëm në shumicën e IP-ve.

Mirëpo, nevojitet shtim i kontrolleve menaxheriale dhe monitorimit nga ana e zyrtarëve kryesor llogaridhënës në IP në fushën e planifikimit të buxhetit, menaxhimit të pagave dhe mëditjeve dhe menaxhimit të pasurisë për të siguruar menaxhim të qëndrueshëm të parasë publike.

Në shumicën e rasteve institucionet që gjenerojnë të hyra arriten të ndërtojnë sisteme adekuata për regjistrim, mirëmbajtje dhe raportim të të hyrave<sup>11</sup>. Nevoja për konsolidimin e kontrolleve në fushën e menaxhimit financiar është vërejtur në institucionet e themeluara rishtazi. Kjo mungesë e konsolidimit dhe funksionalizimit në këto institucione kryesisht ka rezultuar si pasojë e mungesës së stafit të mjaftueshëm, përkrahjes buxhetore dhe mos emërimit të zyrtarëve të lartë publik me kohë.

<sup>10</sup> ZAP në kuadër të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) ka audituar edhe Fondin e Mirëbesimit. Për këtë ZAP ka dhënë dy Opinione të auditimit brenda një raporti.

<sup>11</sup> Përfshirë këtu është Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), ku sistemi ende nuk i plotëson nevojat.

Vetëvlerësimi ishte kryer formalisht në shumicën e IP-ve, megjithatë përfitimi nga ky proces nuk është përdorur për të identifikuar përparësitë dhe dobësitë e sistemeve ekzistuese si dhe aspekteve potenciale për zhvillim dhe përmirësim.

Si rezultat i rekomandimeve tona të mëhershme, pothuajse shumica e IP-ve gjatë vitit 2012 kishin marrë në konsideratë rishikimin e shpenzimeve operative për të siguruar shërbime më efikase me kosto më të ulët.

Raportimi i IP-ve në Kuvend dhe në komisione të tij nuk është i rregulluar mirë dhe në shumicën e rasteve ata prodhojnë raporte operationale të performancës së tyre ndaras nga raportet financiare, dhe në kohë të ndryshme. Përveç se kjo u merr shumë kohë IP-ve, u merr kohë edhe komisioneve të Kuvendit, të cilët duhet ti shqyrtojnë ato ndaras, dhe kjo nuk siguron një proces efikas të llogaridhënies për menaxherët e IP-ve.

### Mangësitë kyçe dhe sfidat e IP-ve gjatë vitit 2012

#### **Planifikimi dhe realizimi i buxhetit**

IP-të përballen me një numër sfidash që lidhen me pavarësinë e tyre (funksionale, financiare dhe operative), llogaridhënien dhe statusin e tyre në procesin e gjerë të buxhetimit. Në krahasim me vitin 2011, MF gjatë vitit 2012 ka aplikuar shkurtime buxhetore dhe reduktim të alokimeve në një shkallë më të vogël. Kjo, së bashku me paraqitjen (futjen) e raportimit financiar të IP-ve në kërkesën e tyre buxhetore dhe formave të raportimit financiar të kërkesave buxhetore në Komisionin e Kuvendit për Buxhet dhe Financa, janë tregues i rritjes së nivelit të pavarësisë financiare të IP-ve.

Megjithatë, përkrahja buxhetore në institucionet si: Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (ASHMDHP) dhe Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë (KKTK) nuk ishte ofruar në nivelin e kërkuar gjatë vitit 2012 dhe për pasojë ka rrjedhur edhe deficioni buxhetor në këto dy institucione.

Buxheti fillestar për 26 institucionet e pavarura të audituara nga ZAP për vitin 2012 ishte 80,204,056€, ndërsa buxheti final 84,931,330€. Shpenzimi vjetor ishte 70,759,018€ ose shprehur në përqindje 83% e buxhetit final.

Buxheti për paga dhe mëditje ishte realizuar pothuajse në tërësi. Përveç pagesave të rregullta për stafin, vendimmarrësit në disa IP kishin nxjerr vendime për kompensime shtesë të stafit jo në pajtim me kornizën ligjore<sup>12</sup>. Si rezultat i këtyre vendimeve janë paguar 136,477€.

Pjesa më e madhe e buxhetit të pashpenzuar ishte rezultat i mos realizimit të projekteve kapitale. Auditimi ynë për vitin 2012, ka vënë në pah që disa projekte kapitale nuk ishin realizuar fare, përderisa disa projekte ishin ndryshuar me rishikim të buxhetit dhe si pasojë nuk kishin arritur të realizohen deri në përfundim të vitit 2012.

---

<sup>12</sup> Kjo u vërejt fillimisht te Komisioni i Pavarur për Media (KPM), Gjykata Kushtetuese e Kosovës (GJKK) dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), dhe puna jashtë orarit është aplikuar pothuajse në të gjitha IP-të.

### Koordinimi ndërinstitucional

Për shkak se shumica e këtyre IP-ve janë të vogla dhe kryesisht përbëhen nga staf profesional, ata duhet të gjejnë zgjedhje tjera për të mbuluar disa punë administrative që janë të përbashkëta për shumicën e institucioneve dhe që lejohen në bazë të legjislacionit në fuqi. Edhe pse kishte përpjekje, pak është bërë për të adresuar këtë çështje.

Gjatë vitit 2012, Kuvendi i Kosovës dhe AQP kishin ofruar mbështetje në fushën e prokurimit për disa IP<sup>13</sup>. Në disa raste kishte marrëveshje midis IP-ve për shfrytëzimin e shërbimeve të përbashkëta të auditimit<sup>14</sup>, ose në disa raste NjQH/AB e MF vazhdon t'i ofroj këto shërbime për disa nga IP-të.

Në disa raste, ky bashkëpunim midis IP-ve për mbështetje të përbashkët është mëse i nevojshëm në përmbylljen e objektivave strategjike institucionale. Siç është rasti me institucionet në sistemin e gjyqësorit<sup>15</sup>, ose midis KPMM-së në njërin anë dhe prokurorive, MPB-së, MMPH-së si dhe komunave në anën tjetër për të përkrahur zbatimin e ligjit për miniera dhe minerale.

### Hapësirat për punë

Hapësirat për punë shpesh janë të pamjaftueshme dhe nuk ofrojnë standarde themelore për punë. Nga 26 Institucione të audituara, 16 prej tyre janë të vendosura në objekte private. Ekziston nevoja që të ngritet kjo çështje në nivel të Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës pasi që buxheti prej 1,294,966€ i cili aktualisht përdoret për qira nga këto IP, mund të përdoret për aktivitetet tjera operacionale dhe profesionale.

### Pavarësia nga emërimi dhe plotësimi i pozitave të larta publike

Për të respektuar parimet themelore të pavarësisë, është më se e nevojshme që emërimet dhe shkarkimet e anëtarëve të bordit dhe Drejtorëve Ekzekutivi në IP të bëhet vetëm përmes votimit në Kuvend<sup>16</sup>. Mos respektimi i këtij parimi shpie në mundësinë që emërimi i zyrtarëve të lartë publik të cilët nuk janë plotësisht të pavarur dhe nuk janë llogaridhënës ndaj Kuvendit.

Kuvendi duhet të marrë në konsideratë të veçantë nevojën për emërim me kohë dhe vazhdimin e kontratave për pozitat e larta publike (bordet dhe niveli ekzekutiv). Nganjëherë, pozitat e zyrtarëve të lartë publik mbeten të hapura për një periudhë më të gjatë kohore duke shkaktuar kështu pengesa në funksionimin e institucioneve ose edhe disa anëtarë të mos kenë mandat të qartë<sup>17</sup>.

---

<sup>13</sup> Kuvendi ka ofruar shërbime Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Këshillit Kosovar për Trashëgimi Kulturor, ndërsa AQP ka ofruar shërbime Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia.

<sup>14</sup> Siç është rasti mes KPM-së dhe IAP-së

<sup>15</sup> Bashkëpunimi midis KGJK, IGJK, PSH dhe Ministrisë së Drejtësisë

<sup>16</sup> Në kemi vërejtur se emërimi i Bordit dhe Drejtorit Ekzekutiv në kuadër të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës është bërë nga Qeveria. Më tej, Kryeinspektori i Minierave në KPMM-së është emëruar nga Qeveria. Në mënyrë të ngjashme, është e qartë se Kuvendi emëron anëtarët e Bordit të AKP-së, procesi i emërimit të këtyre anëtarëve, nuk është sqaruar sa duhet Kuvendit.

<sup>17</sup> Vonesa në emërimin e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të AKP-së kishte ndal procesin e privatizimit, pasi që të gjitha vendimet e rëndësishme duhej të nënshkruheshin nga Kryetari i Bordit të Drejtorëve. Rasti tjetër është kur KPM-ja gjatë viteve 2011 dhe 2012 kishte punuar në mungesë të Bordit të Komisionerëve të KPM-së dhe në KKTk pesë prej shtatë anëtarëve të Këshillit nuk janë emëruar ashtu siç është paraparë. Për shkak të mungesës së veprimit në zgjatjen e kontratave të tyre, kryetari dhe një anëtar i KKTk janë paguar për tre muaj të tjerë, edhe pse mandati i tyre kishte skaduar.

Zhvillim pozitiv në kuadër të Kuvendit është krijimi i një pike të përhershme kontakti për IP-të për të njoftuar komisionet e Kuvendit për skadimin e mandatave të bordeve dhe anëtarëve të tyre. Kjo do t'i ndihmonte komisioneve relevante të përgatitin proceset e emërimit para skadimit të mandateve.

### **Konkluzion**

IP-të gjatë vitit 2012 në përgjithësi kanë arritur të ndërtojnë sisteme adekuate për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Për më tepër, rishikimi i shpenzimeve operative për të siguruar shërbime me efikasitet me kosto më të ulët tregon përkushtimin e llogaridhënësve kryesor për menaxhim të mirëfilltë të parasë publike. Megjithatë, shtimi i kontrolleve dhe monitorimit është i nevojshëm për të siguruar qëndrueshmëri të plotë dhe vijimësi të sistemit.

Buxheti i shpenzuar prej 83% tregon nevojën për përmirësimin e politikave të planifikimit vjetor dhe ekzekutimit buxhetor nga IP-të. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet sigurimit të alokimeve të mjaftueshme buxhetore, duke përmirësuar bashkëpunimin horizontal në ofrimin e shërbimeve të përbashkëta administrative për IP-të e vogla.

Kemi vërejtur një përkushtim më të madh nga Kuvendi në ndërmarrjen e masave proaktive dhe zhvillimit të mëtutjeshëm të IP-ve në krahasim me vitet e mëhershme. Shpresojmë se themelimi i Zyrës Koordinuese do të trajtoj çështjen e vonësve në emërimin dhe vazhdimin e mandateve për Bordet dhe anëtarët e bordeve. Më tutje, edhe llogaridhënia e menaxherëve kryesor të IP-ve është në rritje. Në këtë drejtim, KMFP dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa kanë luajtur një rol më aktiv.

Për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit, dhe për të kontribuar më tej në rritjen e nivelit të përgjegjshmërisë së IP-ve, mund të analizohet një modifikim i kërkesave të raportimit të jashtëm. Ideja themelore është se IP-të duhet të paraqesin performancën e tyre operationale dhe performancën financiare në një raport të vetëm, që do të auditohet para se të dorëzohet në Kuvend. Kjo do të mbështesë atë në kuptimin e nevojave dhe sfidave të IP-ve, duke mbajtur llogaridhënës për performancën, dhe duke e bërë punën më pak të rëndë.

### **Rekomandimet**

#### ***Unë rekomandoj Qeverinë të:***

- Siguroj transparencë të plotë dhe të jetë më efikas në komunikim me Institucionet e Pavarura me qëllim të informimit me kohë për kërkesat dhe procedurat e reja në fuqi.

#### ***Unë rekomandoj Kuvendin që të marrë parasysh:***

- Ofrimin e mbështetjes së plotë zyrës koordinuese dhe qartësimin e rolit të zyrës ndërlidhëse me Institucione të Pavarura në kuadër të Kuvendit për të siguruar informata të mjaftueshme për komisionet e Kuvendit;
- Shtim të komunikimit me Institucionet e Pavarura dhe trajtimin më me kujdes të kërkesave buxhetore me qëllim të sigurimit të fondeve të mjaftueshme që të ushtrojnë fushëveprimtarinë e tyre në mënyrë të plotë; dhe
- Shqyrtimin e mundësive për krijimin e kërkesave të reja raportuese, duke kombinuar raportimin financiar dhe raportimin operativ duke hapur kështu rrugën për një dialog më të zhvilluar për buxhetin; Kjo duhet të mbështesë rritjen e nivelit llogaridhënies së Institucioneve të Pavarura për parane e shpenzuar publike.

### 5.3 Komunat

Ne kemi kryer auditimin e të gjitha komunave (38) për vitin 2012<sup>18</sup>. Nga këto, 11 prej tyre janë kontraktuar tek kompanitë e njohura ndërkombëtare private të auditimit.

Opinione të Pa kualifikuara janë dhënë për 30 komuna (25 me theksim të çështjes), Opinione të Kualifikuara për pesë komuna, ndërsa për tre komuna është dhënë Mohim Opinioni. Në përgjithësi, kjo tregon përparim në krahasim me vitin e kaluar.

**Tabela 12: Ndryshimet e opinioneve në tri vitet e fundit**

Opinionet e auditimit	Viti 2012	Viti 2011	Viti 2010
Të pakualifikuara	5	2	0
Të pakualifikuara me theksim të çështjes	25	14	12
Të kualifikuara	5	18	16
Mohim i opinionit	3	3	9
<b>Gjithsej:</b>	<b>38</b>	<b>37</b>	<b>37</b>

#### Vetëqeverisja lokale dhe përgjegjësitë

Përveç granteve nga niveli qendror, të aprovuara sipas Ligjit të ndarjeve buxhetore, burimet financiare të komunës përbëhen prej të hyrave nga tatimet, grantet operative, grantet për kompetenca e zgjeruara<sup>19</sup>, grantet e jashtëzakonshme, përfitimet nga huadhëniet komunale. Në pak raste disa komuna pranojnë ndihma financiare nga Republika e Serbisë.

Nga Kryetarët e komunave kërkohet që të përgatisin raporte tremujore dhe ato t'ia dorëzojnë Kuvendeve Komunale respektive të Komunës gjatë tërë një viti fiskal, dhe një kopje i dërgohet MF. Këto raporte pastaj publikohen në ueb faqen e komunës. Çdo raport tremujor duhet të përmbajë raportin e të hyrave dhe shpenzimeve, informata për investimet dhe borxhet, si dhe një përmbledhje të gjendjes së të gjitha projekteve për shpenzime kapitale.

Kryetari i Komunës ia dorëzon Kuvendit të Komunës një raport përfundimtar të buxhetit e vitit aktual si dhe për dy vitet e kaluara fiskale.

#### Financimi i komunave

Shpenzimet totale të komunave për vitin 2012 ishin 367,296,565€<sup>20</sup>, apo 25% e shpenzimeve totale të BK-së. Gjatë vitit 2012, Komunat kishin inkasuar 59,447,721€ të hyra vetjake që përbën vetëm 15% të financimit të përgjithshëm të komunave, por që shënon rritje për 6.8%. Krahasuar me vitin 2011, Buxheti final i komunave ishte shpenzuar në shkallën mesatare prej 89%.

<sup>18</sup> Këtu është përfshirë edhe Zyra Administrative në Mitrovicën Veriore.

<sup>19</sup> Llojet e kompetencave të zgjeruara në mënyrë të detajuar janë përshkruar në nenet 19-23 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, ndërsa buxheti për kompetenca të zgjeruara është përshkruar në nenin 6 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049.

<sup>20</sup> Në vitin 2011 ishin shpenzuar 363,782,562€.

### Zbatim i rekomandimeve nga viti i kaluar

Megjithëse vërejmë një përmirësim të lehtë në nivelin e adresimit të rekomandimeve gjatë vitit 2012, ende nuk jemi plotësisht të kënaqur me rezultatet.

Në raportet e nxjerra për 34 komuna<sup>21</sup> për vitin 2011 kemi dhënë 299 rekomandime, prej të cilave gjatë vitit 2012, 63% ishin adresuar plotësisht ose pjesërisht, dhe 37% të tyre nuk ishin adresuar fare<sup>22</sup>. Për me tepër, 5 komuna nuk kishin përgatitur as Plan veprimi për adresimin e rekomandimeve<sup>23</sup>.

Më tej, në RVA për vitin 2011 kemi dhënë rekomandimin që të futet pozita e menaxherit ekzekutiv në komuna në mënyrë që të kemi horizont më të gjerë të planifikimit dhe fokus më të mirë për nevojat e qytetarëve. Kjo nuk është implementuar.

### Reformat në Menaxhimin e Financave Publike të Qeverisjes Lokale

Në vitin 2010 filloi reforma në Menaxhimin e Financave Publike (MFP)<sup>24</sup> të qeverisjes lokale. Kjo reformë kishte filluar duke bërë vlerësimin e MFP-së sipas metodologjisë PEFA-së dhe ishte ndarë në dy runde. Rundi i parë ishte ekzekutuar gjatë periudhës Qershor 2010 – Maj 2011 dhe përfshinte komunën e Prishtinës, Podujevës, Vushtrrisë, Mamushës dhe Shtërpçës. Rundi i dytë që ishte ekzekutuar gjatë periudhës Qershor 2011 – Shkurt 2012 përfshinte komunën e Pejës, Istogut, Gjakovës, Gjilanit, Ferizajt dhe Novobërdës.

Kjo reformë është bërë nën kujdesin e Ministrisë së Financave dhe është përkrahur nga donatorët e jashtëm. Projekti i vlerësimit të MFP-së është implementuar nga Deloitte. Vlerësimi mbulonte shtatë (7) komponentë kyç të MFP-së:

- Kredibilitetin buxhetor;
- Gjithëpërfshirjen dhe transparencën;
- Buxhetimin e bazuar në politika;
- Parashikueshmërinë dhe kontrollin e ekzekutimit të buxhetit;
- Kontabilitetin, regjistrimin dhe raportimin;
- Shqyrtimin dhe auditimin e jashtëm; dhe
- Praktikën e donatorëve.

Ky proces kishte rezultuar me një Plan të Veprimit për MFP që përmbante indikatorë dhe notime të komunave, përparësitë, dobësitë, veprimet e nevojshme dhe institucionet përgjegjëse për implementim.

Progres është arritur në disa komuna, në përmirësimin e performancës buxhetore përmes zvogëlimit të përqindjes së devijimit të shpenzimeve të buxhetuara, planifikim më realist të të hyrave vetjake të Komunës, rritje të shkallës së mbledhjes së borxhit nga tatimi në pronë, funksionalizmin dhe

---

<sup>21</sup> Duke përfshirë Zyrën Administrative në Mitrovicën Veriore, Leposaviqin, Zubin Potokun dhe Zvečanin.

<sup>22</sup> Përkushtim më i madh për zbatimin e rekomandimeve është vërejtur në komunën e Prishtinës, Malishevës, Graçanicës, Ranillugut dhe Vushtrrisë, ndërsa komunat që ishin më pak të përqendruara në adresimin e rekomandimeve tona ishin komuna e Skenderajt, Deçanit, Kaçanikut dhe Podujevës.

<sup>23</sup> Komuna e Gjakovës, Klokotit, Rahovecit, Obiliqit dhe Junikut)

<sup>24</sup> Reforma e MFP-së e bazuar mbi metodologjinë e shpenzimeve publike dhe llogaridhënien financiare (PEFA)

operacionalizmin e NJAB-së, si dhe përpjekje për rritjen e numrit të rekomandimeve të implementuara të auditorit të brendshëm; përgatitja e pasqyrave financiare sipas SNKSP-së, dhe përmirësime në ushtrimin e funksionit mbikëqyrës të asambleve komunale karshi qeverive komunale sa i përket financave lokale (komunale)<sup>25</sup>.

Me gjithë progresin e arritur në zbatimin e reformës në MFP, në komunat e përfshira në këtë program, ende mbetet rrugë e gjatë para se të mund të konsiderohet që reforma është implementuar. Në këtë raport janë identifikuar fusha ku ende janë të nevojshme përmirësime të mëtutjeshme. Gjithashtu është konkluduar që ekzistojnë çështje që nuk mund të zbatohen në periudha afat-shkurta por kërkohet zotim dhe përkushtim afat-gjatë nga ana e institucioneve përgjegjëse deri në implementimin e plotë të tyre.

Sfidat kryesore që mbetin përballë zbatimit të reformës së MFP-së në qeveritë lokale janë:

- Krijimi i proceseve buxhetore të udhëhequra nga prioritetet dhe politikat strategjike;
- Shkallë e lartë e obligimeve të papaguara dhe rreziku i mos regjistrimit dhe mos raportimit të plotë të tyre;
- Ndërlidhje e dobët ndërmjet KASH dhe buxheteve vjetore të komunave;
- Analizimi i llogarive dhe buxhetit nga përfaqësuesit e zgjedhur për shkak të mungesës së kapaciteteve;
- Dobësitë në sistemin e kontrolleve të brendshme;
- Funkcionim i dobët i auditimit të brendshëm, komiteteve të auditimit dhe nivel i ulët i implementimit të rekomandimeve të tyre;
- Mungesa e kuptimit të rëndësisë së KBFP-së nga menaxhmenti i lartë;
- Implementimi në kohë i rekomandimeve të ZAP-it; dhe
- Forcimi i koordinimit me donatorët e jashtëm dhe Ministrinë për Integritet Evropian.

### **Kërkesat ligjore mbi raportimin financiar**

Disa komuna kanë dështuar në plotësimin e disa kërkesave ligjore mbi raportimin financiar.

Ato janë si në vijim:

- Tetë komuna nuk kanë përgatitur PVF-të në pajtim me Rregullën Financiare Nr.07/2011 mbi raportimin vjetor të OB-ve;
- Tri komuna nuk e kanë përmbushur obligimin për raportim periodik në MF, si dhe nuk kanë përgatitur fare PVF; dhe
- Vetëm 17 komuna kanë përgatitur PVF-të e tyre në të dy gjuhët zyrtare.

### **Gjetjet kyçe të auditimit në Komuna**

Gjatë auditimit për vitin 2012 të komunave janë identifikuar dobësi serioze nëpër fusha të caktuara. Në vazhdim janë disa nga çështjet kyçe:

- Mos adresimi i rekomandimeve të auditimit të dhëna nga ZAP;
- Kontrolle të brendshme të pa mjaftuara në sistemin e prokurimit në shumë komuna;
- Mungesë të kontrolleve përgjatë mbikëqyrjes së kontratave të investimeve kapitale dhe dobësi në certifikimin e pagesave;

---

<sup>25</sup> Edhe pse është ende në një nivel jo të kënaqshëm, ne duhet të theksojmë se qeveritë komunale kanë përmirësuar ndjeshëm procesin e trajtimit të rekomandimeve të ZAP.

- Mjetet e destinuar për investime kapitale, janë shpenzuar për qëllime subvencionesh dhe trajnime;
- Hyrja në obligime kontraktuese pa mjete të mjaftueshme të buxhetuara;
- Obligimet e shumicës së komunave kanë shënuar rritje;
- Disa komuna po përballen me problemin e prezantimit dhe shpalosjen e pagesave nga palët e treta;
- Dhënia e subvencioneve jo në përputhje me rregulloret e brendshme komunale dhe mungesë e informacioneve kthyesë nga ana e përfituesve për mënyrën e shfrytëzimit të subvencionit;
- Në disa Komuna realizimi i planit në arkëtimin e të hyrave vetjake ishte i dobët në mungesë të mekanizmave efektiv për arkëtimin e të hyrave vetjake, kryesisht nga debitorët për tatim në pronë, Lejet e veprimtarisë së bizneseve dhe pronave të dhëna me qira;
- Regjistrat e pasurive jo të plotë dhe jo të besueshëm;
- Tek disa komuna NjAB-të nuk kanë arritur të realizojnë planet e tyre audituese dhe nuk i kanë mbuluar fushat me rrezik të lartë, si: procedurat e prokurimit, menaxhimin e kontratave të mëdha të ndërtimeve, të arkëtueshmet nga të hyrat vetjake; dhe
- Në asnjë komunë menaxhmenti nuk ka plan veprimi për implementimin e rekomandimeve të dhëna nga NjAB.

### **Rekomandime**

#### ***Unë rekomandoj Qeverinë të sigurojë që:***

- Korniza raportuese të rishikohet, ku do të qartësohet mënyra e prezantimit dhe shpalosjes së pagesave nga palët e treta dhe që të hartohen praktikatat më të mira dhe ato u janë komunikuar organizatave buxhetore;
- Reforma e Menaxhimit të Financave Publike të përfshijë të gjitha komunat; dhe
- Të ekzistojë një angazhim i shtuar në koordinimin e të gjitha palëve të interesit në zbatimin e reformës së Menaxhimit të Financave Publike.

#### ***Unë rekomandoj Kuvendet Komunale të sigurojnë se:***

- Ekzekutivi harton plane veprimi të detajuara duke përfshirë aktivitetet, kohën dhe personat përgjegjës për adresimin e rekomandimeve të Auditorit të Jashtëm dhe Auditorit të Brendshëm; dhe
- Raportet e Auditorit të Jashtëm diskutohen në kuvendet komunale; dhe të ketë përcjellje të implementimit të rekomandimeve të dhëna nga Auditori i Përgjithshëm.

#### ***Unë rekomandoj Kuvendin që të marrë parasysh:***

- Futjen në funksion të një Menaxheri Ekzekutiv si nëpunës më i lartë civil, përgjegjës për menaxhimin e aktiviteteve të përditshme dhe shërbimeve për qytetarët; dhe
- Fuqizimin e mbikëqyrjes të performancës së komunave në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

### 5.4 Ndërmarrjet Publike dhe Shoqërore

#### 5.4.1 Ndërmarrjet Publike (NP)

Ndërmarrjet publike (NP)<sup>26</sup> janë në pronësi të Republikës së Kosovës. NP-të janë të kategorizuara si:

- Ndërmarrje Publike Qendrore dhe Rajonale; dhe
- Ndërmarrje Publike Lokale.

Ndërmarrjet Publike qendrore dhe Regjionale mbikëqyren dhe monitorohen direkt nga Ministria për Zhvillim Ekonomik<sup>27</sup> si përfaqësues i pronarit. NP-të lokale janë në pronësi të Komunës apo në disa raste të një numri Komunash së bashku. Secila Komunë është e obliguar të nxjerrë një politikë të pronësisë e cila i paraqet objektivat e përgjithshme të komunës në lidhje me pronësinë e NP-së Lokale si dhe rolin e saj në qeverisjen e përbashkët të tyre. Bordet e Drejtorëve janë të obliguara të mbikëqyrin punën e menaxhmentit në mënyrë që të arrihen objektivat dhe NP-të të japin rezultate.

Të drejtat e aksionarit të një komune ushtrohen nga Komisioni Komunal i Aksionarëve (KKA) i cili përbëhet nga një anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe dy anëtarë të tjerë të emëruar nga Kuvendi Komunal. Nëse një NP Lokale ofron shërbime për më shumë se një komunë, përqindja e pronësisë së secilës komunë do të jetë e barabartë me përqindjen e klientëve të regjistruar të kësaj NP Lokale në atë Komunë.

ZAP ka fuqinë që të ndërmarrë auditime statutores të NP-ve. Si ushtrim i kësaj të drejte, AP-ja vendos çdo vit rreth tyre, për cilat MEZH informohet me kohë. Përveç auditimeve statutores, ZAP gjithashtu kryen auditime të performancës dhe menaxheriale për të shikuar më thellë në cilësinë e menaxhimit dhe shërbimeve të ofruara.

#### Veprimet Lidhur me Rekomandimet e Mëhershme

Për vitin financiar 2011, ne publikuam pesë (5) raporte auditimi<sup>28</sup> për 12 entitete të audituara, të cilat rezultuan me 49 rekomandime në total. Këto rekomandime iu janë dhënë (Qeverisë dhe Kuvendit) me qëllim përmirësimin e performancës së NP-ve. Shumica e entitete të audituara kanë hartuar planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna<sup>29</sup>.

Në RVA-në e vitit 2011 katër rekomandimet tona kryesore për Qeverinë ishin:

#### Rekomandimet e vitit të kaluar për Qeverinë ishin

- Rritja e nivelit të llogaridhënies duke forcuar zbatimin e Ligjit të ndryshuar të NP-ne në praktikë;
- Forcimi i llogaridhënies duke futur në përdorim sistemet e duhura të menaxhimit dhe mbikëqyrjes;

---

<sup>26</sup> Në total ekzistojnë 61 NP, nga të cilat 17 janë qendrore dhe 44 janë lokale.

<sup>27</sup> Njësia për politikën dhe monitorimin e Ndërmarrjeve Publike u themelua në kuadër të MEZH për të ndihmuar Qeverinë në ushtrimin e përgjegjësisë së saj mbi NP-të dhe mbikëqyrjen e bordeve mbi performancën e arritur. Ajo i raporton Kuvendit dhe publikut për mënyrën se si ato menaxhohen.

<sup>28</sup> Nga të cilat 1 ishte auditim statutor dhe 4 auditime menaxheriale.

<sup>29</sup> Përfundim nga kjo bën RTK që nuk ka hartuar një plan veprimi brenda afatit të kërkuar kohor. Plan veprimi për adresimin e rekomandimeve tona u hartua pasi presionit të Kuvendit (përmes KMFP) pas pothuajse një viti.

- Fokusimi mbi aktivitetet e Bordeve në përmirësimin e performancës për të siguruar funksionimin e procesit të të hyrave dhe një raportin të besueshëm financiar; dhe
- Hartimi i udhëzuesve të unifikuar të menaxhimit, të cilët do të ndihmonin NP-të në rritjen e kultivimit e transparencës dhe ambientit të duhur të kontrollit.

Dy rekomandimet tona kryesore për Kuvendin ishin që të përcjellin nga afër cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimit ndaj qytetarëve nga ndërmarrjet publike, dhe që të kërkojnë nga Qeveria të dorëzonte një raport mbi performancën e ndërmarrjeve publike<sup>30</sup>.

Si përgjigje ndaj një kërkesë nga ana e Kuvendit, një raport i tillë ishte hartuar nga NJPMNP. Edhe pse ka ende fusha të performancës që duhet të adresohen në këtë raport, ne e konsiderojmë këtë si një hap të parë pozitiv në ngritjen e nivelit të llogaridhënies së NP-ve në Qeveri dhe në Kuvend lidhur me performancën e tyre dhe shërbimeve të ofruara. Kur diskutohet për performancën, NJPMNP duhet të përfshijë edhe përcjelljen se si NP-të adresojnë rekomandimet e dhëna nga AP.

### **Sfidat me të cilat ballafaqohen NP-të qendrore**

Në auditimin e vitit 2012, ne kemi identifikuar disa dobësi në performancën e NP-ve<sup>31</sup>.

Dobësitë dhe sfidat e identifikuara janë:

- Ndërmarrjet Publike të audituara kanë operuar vazhdimisht me humbje financiare dhe kanë treguar se janë të varura nga subvencionet e Qeverisë, gjë që tregon pasiguri në lidhje me mundësitë financiare për vijimësinë e biznesit në formën aktuale;
- Në një numër të madh rastesh, menaxhimi i prokurimit në këto Ndërmarrje nuk ishte në pajtim me kërkesat e aplikueshme;
- Ka pasur mungesë të kontrolleve të burimet njerëzore ku mbikëqyrja gjatë procesit të rekrutimit nuk ka qenë shumë efektive;
- Menaxhimi i pasurive nuk ishte efikas dhe kishte mangësi në vlerësimin dhe regjistrimin e tyre; dhe
- Në përgjithësi, nuk kishte mjedis funksional të kontrollit.

### **Sfidat me të cilat ballafaqohen Kompanitë rajonale të mbeturinave (KRM-të)**

Përveç disa dobësive të përgjithshme të prezantuara më lart, ne kemi identifikuar një numër dobësish tek kompanitë e mbeturinave të nivelit lokal në mënyrë specifike, siç janë:

- Organizim dhe kontrole të pamjaftueshme në kompanitë që ofrojnë këto shërbime;
- Një numër i madh i popullsisë vazhdon të mos merr shërbimet e duhura të grumbullimit të mbeturinave nga këto kompani;
- Shërbimet e grumbullimit të mbeturinave nuk janë të përhapura në të gjitha zonat e komunave përkatëse<sup>32</sup>, të cilat rezultojnë me krijimin e një numri të madh të vendgrumbullimeve të paligjshme; dhe
- Ndonëse të obliguara me ligj, kompanitë nuk kanë hartuar raporte vjetore mbi kënaqësinë e klientit, të cilat duhet të ofrojnë përgjigje si për kompanitë ashtu edhe për komunat mbi nivelin dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara.

<sup>30</sup> Qëllimi i këtij raporti duhet të jetë vlerësimi se si zbatohen në praktikë mekanizmat e llogaridhënies të paraqitura në kornizën ligjore.

<sup>31</sup> Të njëjtat dobësi vlejnë edhe për NSH-të.

<sup>32</sup> Kemi vërejtur trendin e përqendrimit në zonat urbane, duke i lënë zonat rurale komplet të pambuluara me shërbim.

### **Sfidat me të cilat ballafaqohen Komunitat në menaxhimin e KRM-ve<sup>33</sup>**

- Si aksionare të NP-ve, ato nuk kanë nxjerrë akte të mjaftueshme nënligjore dhe legjislacion sekondar në mënyrë që të organizojnë si duhet sistemin lokal për menaxhimin mbeturinave;
- Ato nuk kanë siguruar lokacionet adekuate për vendosjen e kontejnerëve dhe nuk kanë organizuar procesin e klasifikimit të mbeturinave; dhe
- KKA-të nuk e kanë kryer si duhet rolin e tyre mbikëqyrës që kanë ndaj kompanive të mbeturinave dhe Bordit të NP-ve.

### **Konkluzion**

Përkundër angazhimit të bordeve të ndërmarrjeve publike, performanca e këtyre kompanive ka vazhduar të përcillet me humbje të konsiderueshme. Kjo performancë negative rrezikon vijimësinë e këtyre ndërmarrjeve.

Kontrollet jo adekuate në përgjithësi tregojnë se menaxhmentet e këtyre ndërmarrjeve ende nuk kanë siguruar mjedis funksional të kontrollit në mënyrë që të sigurojnë menaxhim efektiv dhe efikas të parasë publike.

Dobësitë janë vërejtur në menaxhimin e burimeve njerëzore, prokurim dhe trajtim të pasurive që paraqet sfida. Fokusi i NP-ve dhe qeverive lokale duhet të jetë në ngritjen e efikasitetit në këto aktivitete si dhe të angazhohen për forcimin e këtyre fushave ku ndodhin më shumë mangësi.

Sistemi lidhur me administrimin dhe menaxhimin e mbeturinave në përgjithësi nuk është dizajnuar si duhet për të zbatuar një proces efektiv të mbledhjes dhe deponimit të mbeturinave.

Komunitat nuk kanë arritur të krijojnë parakushte të mjaftueshme për zhvillim të veprimtarisë të KRM-ve dhe nuk kanë zbatuar mbikëqyrje të mjaftueshme për të siguruar një performancë më të mirë të këtyre kompanive. Kompanitë kanë mangësi në kryerjen e shërbimeve cilësore dhe në përputhje me standardet. Raportimet lidhur me menaxhimin tek të gjitha nivelet institucionale e përfshira është i dobët dhe si pasojë ka mungesën e një llogaridhënie të qartë lidhur me problemet për menaxhimin e mbeturinave.

### ***Unë rekomandoj Qeverinë që të sigurojë:***

- Krijimin e forumeve në mes të Qeverisë dhe të ndërmarrjeve për të diskutuar sfidat me të cilat përballen dhe mundësitë për të përmirësuar performancën dhe shërbimet;
- Se raporti i lëshuar nga NJPMNP mbi operacionet e NP-ve përfshin një shkallë më të lartë të informacionit mbi performancën e NP-së dhe kontributin e tyre në përmbushjen e objektivave të caktuara;
- Shkallë më të lartë të bashkëpunimit ndërmjet ministrive në lidhje me zbatimin e politikave dhe fushave të ndryshme të politikës; dhe
- Se NJPMNP kryen përcjellje të rregullt se si NP-të adresojnë rekomandimet e dhëna nga ZAP.

---

<sup>33</sup> Edhe pse disa KRM ndonjëherë mbulojnë më shumë se një komunë të vetme, ato konsiderohen si NP Lokale.

### **Unë rekomandoj Kuvendin që të marrë parasysh se:**

- Në mënyrë aktive përcjell veprimet e Qeverisë duke shikuar performancën e NP-ve në lidhje me politikat e vendosura për ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët, si dhe sfidat me të cilat përballen në këtë proces; dhe
- Informata prapavajtëse i ofrohen NJMPNP mbi përmbajtjen e analizës së performancës së NP-ve, të përfshijë edhe informatë jo vetëm me performancën operacionale dhe financiare, por edhe analizën e mangësive në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarit..

### **5.4.2 Ndërmarrjet Shoqërore**

Ndërmarrjet Shoqërore (NSh) përfaqësohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP). Funkzioni i AKP-së është administrimi dhe privatizimi i NSh-ve dhe pasurive të tyre<sup>34</sup>.

Për herë të parë, ne kryem një auditim statutor të rregullsisë në dy pjesët e Trepçës (jugore dhe veriore)<sup>35</sup> në mënyrë që të japim një pasqyrë të plotë të saj si njësi. Ne kemi identifikuar se:

- Është bërë progres pasi që për herë të parë u prezantuan pasqyrat e integruara financiare për të dyja pjesët e Trepçës. Këto pasqyra u përgatitën nën monitorimin e drejtpërdrejtë të AKP-së. Megjithatë;
- Edhe pse ligjërisht është administratori, AKP—ja nuk ka ndërmarrë veprime për të integruar dhe bashkëpunuar me dy pjesët në një ndërmarrje të vetme;
- AKP nuk ka siguruar rregulla të qarta mbi mënyrën e administrimit dhe kryerjes së obligimeve që rrjedhin nga Ligji mbi riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurive të tyre;
- Përveç shmangieve nga raportimi, nuk ishte dhënë asnjë informacion në lidhje me administrimin dhe fazën e riorganizimit të kompanisë. Lista e pasurive dhe obligimeve të saj, duke rritur kështu pasiguritë në lidhje me pretenduesit e mundshëm;
- Dobësitë e tjera të identifikuar lidhen me saktësinë dhe plotësinë e vlerës së pasurive, shpalosjen në lidhje me rezervat minerale të ndërmarrjes dhe çështjet tatimore me ATK
- Pasqyrat Financiare të NSh Trepça nuk përmbajnë informacion të mjaftueshëm dhe gjithëpërfshirës; dhe
- Dobësi të shumta janë identifikuar gjithashtu në procesin e menaxhimit të të hyrave, prokurimit, dhe personelit si dhe në funksionimin e kontrolleve të brendshme.

Riorganizimi i NSh Trepça është një sfidë për AKP-në. Mangësitë e identifikuar në AKP shkaktojnë pasiguri në riorganizimin e Trepçës dhe procesin e administrimit, dhe kanë një ndikim negativ në veprimtarinë e ndërmarrjes në të ardhmen. Mungesa e integritetit dhe funksionimit të NSh Trepça si një e tërë, tregon se nevojiten përpjekje të mëtejshme nga ana e Bordit të AKP-së dhe të menaxhmentit të Trepçës për të siguruar raportim financiar të unifikuar, transparencë dhe llogaridhënie në lidhje me aktivitetet e ndërmarrjes si një e tërë.

---

<sup>34</sup> Ky autorizim përfshin autorizimin për shitjen, transferimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve dhe pasurive të tyre.

<sup>35</sup> Edhe pse ato janë audituar veçmas sepse operojnë në dy vende të ndara, ne e konsiderojmë atë si një ndërmarrje shoqërore të vetme dhe kemi dhënë një opinion për Trepçën si e tërë.

### Rekomandimet

#### ***Unë rekomandoj Kuvendin që të marrë parasysh:***

- Që të kërkojë nga Bordi i AKP-së që të ofroj rregulla të qarta mbi mënyrën e administrimit, bashkëpunim të duhur mes menaxherëve të Trepçës, shtrin autoritetin në të gjithë ndërmarrjen dhe siguron procesin e duhur të riorganizimit të NSH Trepça.
- Që të kërkojë nga Bordi i AKP-së që Menaxherët e Trepçës do të hartojnë PVF-të e unifikuara që përmbajnë informacion të plotë, siç kërkohet sipas ligjit dhe SNRF, ndërsa Bordi i AKP-së të përcjellë bashkëpunimin e tyre; dhe
- Menaxherët e Trepçës të sigurojnë ambient adekuat të kontrolleve mbi aktivitetet e tyre të biznesit, në mënyrë që të eliminohen dobësitë dhe ato të jenë të orientuara drejt bashkëpunimit adekuat. Duhet të ketë funksionim dhe kontrolle të brendshme të unifikuara, si dhe raportet e rregullta financiare të AKP-së duhet gjithashtu të jenë të unifikuara dhe transparente.

### 5.5 Privatizimi

AKP-ja është një organ i pavarur publik i cili kryen funksionet dhe përgjegjësitë e tij në mënyrë plotësisht të pavarur për sa i përket implementimit të programeve të privatizimit. Rezultatet e privatizimit të NSH-ve potencialisht kanë ndikim të madh mbi ristrukturimin e tregut të Kosovës dhe zhvillimin ekonomik, si dhe ngritjen e mirëqenies për qytetarët. Mandati i AKP-së pritet të përfundojë në vitin 2016, pas përmbushjes së objektivave të saj në privatizim dhe likuidim.

Informacioni financiar i dhënë nga AKP-ja përfshin një sasi të madhe të informacionit që është i vështirë për t'u kuptuar nga shumica e vendimmarrësve politikë, duke rritur frikën dhe rrezikun e mungesës së transparencës. Në raportin e auditimit të vitit 2011 kemi kërkuar që informacioni financiar i dhënë nga Bordi dhe Menaxhmenti i AKP-së është thjeshtuar për ta bërë atë të kuptueshme për lexuesit e jashtëm, megjithatë asnjë veprim nuk është ndërmarrë deri më tani.

Privatizimi i NSH-ve që kanë biznes të qëndrueshëm bëhet përmes metodës së spin-off-it. Pasuritë dhe detyrimet e kufizuara të NSH-ve transferohen në një kompani të re (NewCo) të themeluar nga NSH-ja origjinale. Pas shitjes së Ndërmarrjes së Re tek një investitor, të hyrat depozitohen në një llogari të mirëbesimit që do të përdoren për përmbushjen e detyrimeve të papaguara të NSH-ve dhe për tu marrë me ankesa të tjera, duke përfshirë edhe ankesat mbi pronësinë.

Përmes likuidimit vullnetar, pasuritë e NSH-ve likuidohen në përputhje me ligjin dhe politikat operative të Agjencisë. Likuidimet vullnetare lejojnë një dalje të shpejtë nga tregu për ato ndërmarrje të cilat nuk kanë perspektivë për të mbijetuar. AKP-ja mund të fillojë me masa të tilla ku ajo mendon se ato janë në interes të ruajtjes së vlerës së ndërmarrjeve të shuara, dhe në interes të ndonjë pretenduesi në pronësi ose kreditori në ato.

Bilanci i llogarive më 31 dhjetor 2012 ishte në shumën prej 549,403,359€. Totali i të ardhurave gjatë vitit 2012 në Fondin e Privatizimit (FP) ishte në shumën prej 170,611,996€.

### **Sfidat me të cilat ballafaqohet AKP-ja aktualisht janë:**

- Vonesat e shkaktuara në procesin e privatizimit dhe likuidimit për shkak të mungesës së Bordit të Drejtorëve;
- Kontrollat e pamjaftueshme lidhur me shpërndarjen e 20% për punëtorët nga shitja e NSH-ve;
- Përdorimi i fondeve të NSH-ve në likuidim për shërbimet administrative të AKP-së, para zhvillimit të likuidimit të ndërmarrjeve; dhe;
- Përmbytjen e Objektivit për të përfunduar mandatin e saj në 2016

### **Rekomandimet**

#### ***Unë rekomandoj Kuvendin dhe Qeverinë që të:***

- Ofron një procedurë për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, të cilat duhet në mënyrë të qartë të parashohin shpalljen e pozitive, zhvillimin e një procesi të vlerësimit të kandidatëve, dhe paraqitjen e propozimeve për kandidatët për emërim në Kuvend.

#### ***Unë rekomandoj Kuvendin që të marrë parasysh:***

- Krijimin e dispozitave që përcaktojnë qartë afatet kohore për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, për të mos lënë boshllëqe në funksionimin e Agjencisë;
- Se të gjitha të ardhurat nga shitjet, transferimi, likuidimi i NSH-ve, me përjashtim të fondeve të suficitit, mbahen në mirëbesim për pronarët dhe kreditorët si dhe mbrohen nga Agjencia; dhe
- Që të kërkojë nga AKP për të thjeshtëzuar që pasqyrat financiare për llogari të PF-ve në mënyrë që të jenë më të kuptueshme për lexuesit e jashtëm.

### Shtojca I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit

(e shkëputur nga SNISA 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15)..
10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:
  - a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
  - b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
  - c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar
  - d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare
11. **Theksimi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.
12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:
  - a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
  - b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo complete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
  - c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.
13. **Opinionin i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinionin e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinionit I Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionit që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinionit i Kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.
15. **Mohimi I Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriktionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinionit i kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bën të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.
16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

## Shtojca II. Opinionet e auditimit dhe mangësitë kryesore menaxheriale

**Tabela 1: Llojet e Opinioneve**

Nr. Ren	Llojet e Opinioneve	Numri i opinioneve
1	Opinioni i pa kualifikuar	38
2	Opinioni i pa kualifikuar Theksim Çështjes	42
3	Opinioni i kualifikuar	2
4	Opinioni i kualifikuar me Theksim	6
5	Mohim i opinionit	3
	<b>Gjithsej</b>	<b>91</b>

**Tabela 2: Opinionet e pa kualifikuara**

Organizatrat e Audituarat	Buxheti final (000.euro)	Mangësitë kryesore menaxheriale
Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë	53,00	Mos adresim i plotë i rekomandimeve të ZAP-it; Mangësi tek furnizimi me libra shkollor; Mangësi në menaxhimin e investimeve kapitale; Menaxhim jo i mire i borxheve.
Ministria për Zhvillim Ekonomik	46,49	Mos adresim i plotë i rekomandimeve të ZAP-it; Regjistrimi i shpenzimeve në kode ekonomike jo adekuate; Lidhje e kontratave me OE pa zotim paraprak të mjeteve; Vonesë në ekzekutim të pagesave; Kontroll jo i mirë gjatë pranimit të mallit në depo qendrore; Mos respektim i plotë i marrëveshjes për subvencione; Mos harmonizim i pasurive në mes të raporteve; Vonesa në pagesën e obligimeve.
Ministria e Forcave të Sigurisë së Kosovës	34,31	Menaxhimi dhe Monitorimi jo i mire i kontratave; Menaxhim jo i mire i Avanseve; Mangësi në menaxhimin e personelit.
Ministria e Administratës Publike	20,70	Niveli i ulët i realizimit të buxhetit; Mungesa e politikave dhe rregulloreve për subvencione. Mos funksionimi i Njesisë Monitoruese për përdorimin e automjeteve qeveritare; Regjistra jo te plotë të pasurisë jokapitale.
Ministria e Financave	19,12	Mos pajtueshmëri me LPP; Niveli i ulët i realizimit të buxhetit; Kontratat e blerjeve jo te formës standard; Mos përcaktimi i çmimit të naftës (PLATTS) nga një organ kompetent; Regjistrimi i shpenzimeve në kode ekonomike jo adekuate.

## ZYRA E AUDITORIT PËRGJITHSHËM

Këshilli Gjyqësor i Kosovës	18,32	Mos adresim i plotë i rekomandimeve të ZAP-it; Regjistrimi i shpenzimeve në kode ekonomike jo adekuate; Mos përgatitja e Pasqyrat Financiare Nëntë mujore sipas rregullës financiare 06/2011; Mangësi në procesin e prokurimit; Vonesa në mbylljen e avanseve; Mangësi në menaxhimin e personelit; Mos harmonizimi i regjistrit të pasurisë; Mos funksionalizimi i Komitetit të Auditimit
Podujeva	17,46	Mos adresimi i plote i rekomandimeve të ZAP-it ; Niveli i ulët i inkasimit të hyrave; Mangësi në menaxhimin e prokurimit; Procedurat e subvencionimeve jo në përputhje me Rregulloren e brendshme; Regjistrimi i shpenzimeve në kode ekonomike jo adekuate.
Kuvendi i Kosovës	17,00	Moskryerja e vetëvlerësimit të punës; Mos aplikimi i penaleve në rast të vonesave të realizimit të punimeve;
Suhareka	13,65	Mos adresimi i plote i rekomandimeve të ZAP; Planifikim jo i mirë i të hyrave dhe Mos pajtueshmëri me LPP.
Lipjan	12,01	Mungesa e rregulloreve për subvencione dhe transfere; Mangësi në inkasimin e të hyrave; Mangësi në planifikimin e shpenzimeve; Regjistrat jo të plotë dhe të saktë të pasurisë.
Zyra e Kryeministrit	11,05	Niveli i ulët i realizimit të buxhetit; Mangësi në procedurat e prokurimit dhe menaxhimit të kontratave; Regjistrimi i shpenzimeve në kategori dhe kode ekonomike jo adekuate; Vonesa në mbylljen e avanseve; Monitorim dhe raportim jo i mirë i subvencioneve; Mangësi në regjistrimin dhe menaxhimin e pasurisë jokapitale dhe stoqeve.
Doganat	9,12	Mos adresim i plote i rekomandimeve të ZAP; Regjistrimi i shpenzimeve në kode ekonomike jo adekuate; Planifikim jo i mirë i buxhetit; Mos raportim me kohë i stoqeve nga OE-të si shfrytëzues së Depove Doganore; Agjencitë e përfaqësimit të pa licencuara; Mos regjistrimi i pasurive në regjistrin kontabël.
Administrata Tatimore	7,85	Mungesë e funksionimit të kontrollit në mbledhjen e borxheve sidomos ato kritike.

## RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT 2012

Ministria për Kthim dhe Komunitete	7,85	Niveli i ulët i realizimit të buxhetit; Mangësi në menaxhimin e prokurimit; Certifikimi i parregullt pagesave.
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	7,55	Mos adresimi i plotë i rekomandimeve të ZAP-it; Niveli i ulët i realizimit të buxhetit; Mangësi në regjistrimin e të hyrave dhe të arkëtueshmeve; Nënshkrimi i kontratave të paplanifikuara; Mungesa e komisionit për pranim teknik; Vonesa në pagesën e obligimeve; Mangësi në menaxhimin e personelit; Menaxhimi jo adekuat i automjeteve.
Ministria e Qeverisjes Lokale	6,79	Mos adresimi i plotë i rekomandimeve të ZAP-it; Mangësi në ekzekutimin e buxhetit; Regjistrimi i shpenzimeve në kode ekonomike jo adekuate; Mos pajtueshmëri me LPP-në; Mangësi në kontrollin e shpenzimeve për udhëtime zyrtare; Anashkalim i marrëveshjeve për subvencione; Regjistri jo i plotë i pasurive; Mos raportim me kohë në NjQHAB.
Shtime	4,77	Mos adresimi i plotë i rekomandimeve të ZAP-it; Niveli i ulët i inkasimit të hyrave; Procedurat e subvencionimeve jo në përputhje me Rregulloren e brendshme; Regjistrimi i shpenzimeve në kode ekonomike jo adekuate.
Agjencia e Pronave e Kosovës	3,50	Regjistrimi i shpenzimeve në kategori ekonomike jo adekuate; Mospërfshirja në SIMFK e veturave (donacion)
Ministria e Integrimit Evropian	1,55	Mangësi në menaxhimin e avanseve, Mangësi në menaxhimin e personelit dhe menaxhimin e subvencioneve.
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	1,51	Mos adresim i plotë i rekomandimeve të ZAP-it; Planifikim jo i mirë i buxhetit për projektet kapitale; Menaxhim i dobët i të hyrave; Mangësi në menaxhimin e personelit; Mos inventarizimi i pasurisë; Mos përgatitja e planit të veprimit për implementimin e rekomandimeve nga NjAB.
Gjykata Kushtetuese	1,43	Mangësi në menaxhimin e prokurimit; Inventarizimi i pasurisë i kryer me vonesë. Mangësi në shpenzimet për paga dhe mëditje.
Ministria e Diasporës	1,42	Mos realizimi i buxhetit për investime kapitale sipas planin kohor të rrjedhjes së parasë; Shpenzimet për mallra dhe shërbime pa procedura të prokurimit; Menaxhim dhe Monitorim jo i mirë i subvencioneve; Mangësi në procesin e rekrutimit.
DANIDA	1,25	Lëshime të vogla administrative si dhe vonesa të shkaktuara nga stërzgjatja e procedurave të prokurimit.

## ZYRA E AUDITORIT PËRGJITHSHËM

Ranillug	1,23	Mangësi në procesin e rekrutimit; Vonesa në deponimin e mjeteve në llogari bankare; Mos respektimi i procedurave të rekrutimit
Akademia e Shkencave dhe Arteve të	0,82	Mangësi në planifikim të prokurimit.
Autoriteti Rregullativ i Aviacionit	0,79	Mungesa e kryerjes së auditimit të brendshëm
Autoriteti Rregullativ i Komunikacionit Elektronik dhe Postar	0,77	Mos adresim i plotë i rekomandimeve të ZAP-it; Planifikim jo i mirë i buxhetit; Mangësi në procesin e prokurimit; Regjistrimi i shpenzimeve ne kode ekonomike jo adekuate; Mos vlerësimi i pasurive me vlerë të mbetur zero; Mos themelimi i NJAB-it
Avokati i Popullit	0,70	Mos adresimi i plotë i rekomandimeve të ZAP-it; Mangësi në menaxhimin e prokurimit; Menaxhimi jo i mirë i parasë së gatshme.
Zyra Rregullative e Energjisë	0,68	Mos plotësimi i deklaratave vetëvleresuese; Mos inventarizimi i pasurisë; Mos vendosja e bar-kodeve të gjitha pasurisë
Instituti Gjyqësor i Kosovës	0,56	Mangësi në procesin e prokurimit,
Agjencia Kundër Korrupsionit	0,40	Planifikim jo i mirë i buxhetit; Mos pajtueshmëri me LPP; Mos inventarizimi i pasurisë.
Zyra Rregullative për Ujë dhe Mbeturina	0,33	Mangësi në planifikim të prokurimit.
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	0,33	Mos adresimi i plotë i Rekomandimeve të ZAP-it dhe mospërdorimi i sistemit e-Pasuria.
Organi Shqyrtues i Prokurimit	0,29	Mangësi në trajtimin e obligimeve të papaguara.
Komisioni për Ndihmë Ligjore	0,29	Shortcomings in the handling of outstanding liabilities.
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	0,24	Mos përgatitja e raportit vjetor të performancës; Planifikimi jo i mirë i shpenzimeve për mallra dhe shërbime; Mos realizim i kontratave sipas planit të prokurimit; Vonesa në pagesën e obligimeve.
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil	0,22	Furnizim me mbushje të telefonave mobil pa kontratë.
Mbrotja e Trashëgimisë së Kosovës	0,18	Mungesa e kontrollit rreth ekzekutimit të buxhetit për paga; Shpenzime të karburanteve nga paraja e imët; Pagesa e pagës edhe për kundër skadimit të mandatit; Mangësi në procesin e aprovimit dhe llogaritjes së punës jashtë orarit;

## RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT 2012

**Tabela 3: Opinionet e pa kualifikuara me Theksim Çështjes**

Subjektet e Audituar	Buxheti final (mil. euro)	Arsyeja për theksimin e Çështjes	Mangësitë kryesore menaxheriale
Ministria Infrastrukturës	281,16	Regjistri i Pasurive Fikse përfshin në mënyrë të pasaktë vlerën prej 69,327,710€ të pasurive të bashkëfinancuara të cilat duhet të paraqiten në regjistrat e pasurive të Komunave	Mos adresim i plotë i rekomandimeve të ZAP-it; Mangësi në raportimin dhe inkasimin e të hyrave; Licencimi i OE për transportin e mallrave dhe kontroll teknike nuk ishte në përputhje me rregullat; Mangësi në menaxhimin e prokurimit; Mangësi në menaxhimin e personelit; Mangësi në regjistrimin e pasurive.
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	210,02	Informacioni i shpalosur mbi pasuritë nën 1000€ dhe llogaritë e arkëtueshme është jo i plotë.	Mos adresimi i plotë i rekomandimeve të ZAP-it; Mangësi në raportimet e brendshme; Mangësi në menaxhimin e investimeve kapitale.
Ministria e Punëve të Brendshme	95,32	Informacioni i shpalosur mbi pasuritë nuk ishte i plotë dhe i saktë	Mangësi në menaxhimin e prokurimit; Mbulimi i pozitivave me ushtrues detyre; Mangësi tek dhënia e subvencioneve; Menaxhimi jo i mirë i Flotës (mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve në Policin e Kosovës).
Ministria e Shëndetësisë	92,57	Mos shpalosje e saktë e pasurive dhe stoqeve në PVF	Mos implementimi i plotë i rekomandimeve të ZAP-it; Mangësi në raportimet e brendshme financiare dhe operative; Mangësi kishte në planifikimin dhe shpërndarjen e barnave nga lista esenciale, në menaxhimin e investimeve kapitale, në përllogaritjen e kujdestarive.
Prishtina	79,32	Mos shpalosje e saktë dhe e plotë e Llogarive të arkëtueshme dhe nënvlerësim i prezantimit të stoqeve	Mos adresimi i plotë i rekomandimeve të ZAP-it; Mangësi në inkasimin e borxheve; Niveli i ulët i realizimit të buxhetit; Menaxhim jo i mirë i Kontratave të ndërtimit; Regjistrimi i shpenzimeve në kategori ekonomike jo adekuate; Performancë e dobët e NJAB-it.
Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor	61,15	Regjistri i Pasurive Fikse ende nuk është plotësisht i besueshëm	Mos adresim i plotë i rekomandimeve të ZAP-it; Mangësi në menaxhimin e prokurimit; Pagesa e avanseve pa mbulesë sigurimi; Regjistra jo të plotë dhe të saktë të pasurisë.

## ZYRA E AUDITORIT PËRGJITHSHËM

Universiteti i Prishtinës	27,16	Mos shpalesje e saktë e pasurive	Mangësitë në raportimin e të hyrave, Menaxhimi jo i mirë i prokurimit; Mangësi tek pagesa e pagave respektivisht mos aplikimi i ndalesave për orët e humbura.
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	26,16	Regjistri i Pasurive Fikse ende nuk është plotësisht i besueshëm.	Mos adresim i plotë i rekomandimeve të ZAP-it; Mangësi në menaxhimin e subvencioneve; Regjistra jo të plotë dhe të saktë të pasurisë.
Ferizaj	22,18	Informacioni i shpalosur mbi pasuritë nuk ishte i plotë dhe i saktë	Mos adresim i plotë i rekomandimeve të ZAP-it; Nënshkrimi i kontratave të prokurimit pa zotuar fondet e mjaftueshme, Ndarje e qëllimshme e tenderëve për tu ikur procedurave të prokurimit; Mangësi në inksimin e borxheve të vjetra nga tatimi në pronë.
Gjakova	20,12	Regjistri i Pasurive Fikse ende nuk është plotësisht i besueshëm	Mos adresimi i plotë i rekomandimeve të ZAP-it; Mos regjistrimi i plotë i pasurisë jo-financiare; Mangësi në raportimin dhe inksimin e të hyrave; Mos pajtueshmëri me LPP; Mungesa e politikave dhe procedurave për subvencione; Mos regjistrimi i plotë i pronave
Peja	19,79	Regjistri i Pasurive Fikse ende nuk është plotësisht i besueshëm	Mangësi në planifikimin dhe shfrytëzimin e buxhetit; Mangësi në procesin e rekrutimit; Mungesa e rregullores së brendshme për subvencione; Certifikim i parregullt i pagesave; Mangësi në procesin e prokurimit.
Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve	19,45	Mos sqarimi i duhur për mjetet e transferuara tek institucionet vartëse dhe mos shpalesje e saktë e obligimeve	Mangësitë kryesore janë vërejtur tek linjat e komunikimit dhe mos qartësimi i kompetencave dhe përgjegjësi ndërmjet Ministrisë dhe institucioneve vartëse; Mangësi në planifikimin dhe realizimin e buxhetit; Mangësi në menaxhimin e subvencioneve; Mangësi në menaxhimin e burimeve njerëzore.
Gjilan	19,11	Regjistrimi i pasurive në SIMFK nuk ishte i plotë	Planifikim dhe inksim i dobët i të hyrave vetjake ; dobësi gjatë shpenzimeve; dhe menaxhim i dobët i llogarive të pagueshme dhe kontratave për punë dhe furnizime.
Mitrovica	19,02	Regjistri i Pasurive Fikse ende nuk është plotësisht i besueshëm	Mangësi në menaxhimin e prokurimit; Mungesa e rregulloreve për subvencione; Mangësi në inksimin e të hyrave; Mos formimi i komisioneve për vlerësim dhe inventarizim të pasurisë;

## RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT 2012

Ministria e Drejtësisë	18,68	Informacioni i shpalosur mbi pasuritë nuk ishte i plotë dhe i saktë	Mangësi në planifikimin dhe realizimin e buxhetit: Planifikim jo i mirë i prokurimit; Kontrolle jo të mira në raportimin e obligimeve të papaguara; Mangësi në menaxhimin e personelit; Certifikim i parregullt i pagesave; Regjistra jo të plotë dhe të saktë të pasurisë.
Ministria e Punëve të Jashtme	16,52	Shpenzimet për mallra dhe shërbime të MDK-ve nuk ishin aprovuar nga MPJ-ja	Mos adresim i plotë i Rekomandimeve të ZAP-it; Planifikim jo i mirë i prokurimit; Çertifikimi i parregullt i pagesave; Mangësi në menaxhimin e personelit; Dobësi në menaxhimin e automjeteve; Mangësi në raportimin e të hyrave dhe shpenzimeve të MDK-ve
Vushtrri	13,20	Regjistrimi i pasurive fikse dhe pagesat nga palët e treta nuk është i besueshëm.	Mos adresimi i plote i rekomandimeve të ZAP-it; Planifikim jo i mirë i të hyrave; Mangësi në menaxhimin e prokurimit.
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	11,14	Informatat mbi pasuritë fikse nuk janë të plota dhe të sakta	Mos adresim i plotë i rekomandimeve të ZAP-it; Planifikim jo i mirë i shpenzimeve; Projektet kapitale nuk janë proceduar përmes PIP-it; Mos plotësimi i deklaratave vetëvlerësuese; Mangësi në procesin e prokurimit; Mangësi në shpenzimet për paga dhe mëditje; Mangësi në menaxhimin e pasurisë; Mos auditimi i raporteve financiare të subjekteve politike të vitit 2011; Mos publikimi i raportet vjetore financiare të subjekteve politike për vitin 2012 në faqen zyrtare
Skënderaj	10,79	Informacioni i shpalosur mbi pasuritë nuk ishte i plotë dhe i saktë	Planifikim dhe inkasim i dobët i të hyrave dhe shmangie e procedurave të prokurimit publik;
Rahovec	10,50	Informacioni i shpalosur mbi pasuritë nuk ishte i plotë dhe i saktë	Mos adresimi i plote i rekomandimeve të ZAP-it; Pagesa pa procedura të prokurimit nga kategoria e investimeve kapitale; Kontrolle të dobëta tek pronat e dhëna me qira
Malisheva	10,21	Informacioni i shpalosur mbi pasuritë nuk ishte i plotë dhe i saktë	Planifikim dhe inkasim i dobët i të hyrave vetjake dhe shmangie e procedurave të prokurimit publik;
Viti	8,48	Informacioni i shpalosur mbi pasuritë si dhe pagesat nga palët e treta nuk përputheshin me regjistrat përkatës	Planifikim dhe inkasim i dobët i të hyrave vetjake dhe shmangie e procedurave të prokurimit.

## ZYRA E AUDITORIT PËRGJITHSHËM

Kamenica	8,09	Shpalosja mbi pasuritë jo e plotë dhe e saktë	Mosbarazim dhe planifikim e inkasim i dobët i të hyrave vetjake; Shmangie e procedurave të prokurimit.
Klinë	7,51	Informacioni i shpalosur mbi pasuritë nuk ishte i plotë dhe i saktë	Planifikim dhe inkasim i dobët i të hyrave vetjake dhe shmangie e procedurave të prokurimit.
Graçanica	7,43	Informacioni i shpalosur mbi pasuritë fikse është jo i plotë dhe i pasaktë	Planifikim jo i mirë i të hyrave; Mungesa e një rregulloreje të qarta për ndarjen e subvencioneve; Regjistrat jo të plotë dhe të saktë të pasurisë.
Deçan	7,15	Informacioni i shpalosur mbi pasuritë si dhe pagesat nga palët e treta nuk përputheshin me regjistrat përkatës	Planifikim dhe inkasim i dobët i të hyrave dhe shmangie e procedurave të prokurimit;
Fushë Kosova	7,04	Investimet kapitale ishin mbi-vlerësuar për 149,608Eur. Shpalosjet mbi pasuritë dhe stoqet nuk ishin të sakta.	Mangësi në planifikimin e të hyrave; Kontrollë të dobëta të shpenzimeve; Funkcionim i dobët i AB.
Dragash	5,93	Informacioni i shpalosur mbi pasuritë si dhe pagesat nga palët e treta nuk përputheshin me regjistrat përkatës	Planifikim dhe inkasim i dobët i të hyrave vetjake dhe shmangie e procedurave të prokurimit.
Prokurori i Shtetit	5,43	Informatat mbi pasuritë fikse nuk janë të plota dhe të sakta	Mangësi në sektorin e pagesave; Mungesa e kontrolleve në llogaritjen e pagave për punëtorët në pushime të lehonisë; Mangësi në menaxhimin e pasurisë.
Obiliq	5,02	Regjistri i Pasurive fikse jo i besueshëm	Pagesa nga kodet jo adekuate; Shmangie e procedurave të prokurimit.
Shtërpca	4,35	Regjistri i pasurive fikse jo i plotë	Planifikim i dobët i të hyrave vetjake; Mangësi në prokurim; Dobësi gjatë shpenzimit të fondeve.
Administrata në Mitrovicën Veriore	2,94	Regjistri i Pasurive Fikse ende nuk është plotësisht i besueshëm.	Mos përmbushje e kërkesave për raportim të jashtëm; Planifikimin dhe inkasimin e dobët të të hyrave vetjake; Mos shpalosje e informatave për pasuritë në PVF; Shmangie e procedurave të prokurimit; Mos regjistrim të pasurive.
Novo Bërda	2,66	Regjistri i Pasurive fikse jo i besueshëm	Mos adresimi i plote i rekomandimeve të ZAP-it; Mangësi në inkasimin e borxheve; Mangësi në procesin e prokurimit

## RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT 2012

Zyra e Presidentit	2,60	Informacionet e shpalosura në PVF në lidhje me vlerën e pasurive janë të pasakta dhe jo të plota	Planifikim jo i mirë i prokurimit; Mangësi në menaxhimin e pasurisë; Klasifikimi jo i drejtë i shpenzimeve; Vonesa në mbylljen e avanseve.
Hani i Elezit	2,01	Informacioni i shpalosur mbi pasuritë nuk ishte i plotë dhe i saktë	Kontrolle të dobëta në menaxhimin e të hyrave;
Junik	1,61	Informacioni i shpalosur mbi pasuritë nuk ishte i plotë dhe i saktë	Planifikim dhe inkasim i dobët i të hyrave vetjake dhe shmangie e procedurave të prokurimit.
Partesh	1,39	Regjistri i Pasurive Fikse, Llogarive të Arkëtueshme dhe Stoqueve ende nuk është plotësisht i besueshëm	Mungese e evidencës për pasuri dhe Mangësi në procesin e prokurimit.
Kllokot	1,08	Regjistri i Pasurive Fikse ende nuk është plotësisht i besueshëm	Mos adresimi i plote i rekomandimeve të ZAP-it; Planifikim jo i mire i të hyrave; Mos respektimi i procedurave të prokurimit.
Komisioni i Pavarur për Media	0,98	Vlera prej 31,090€ nuk është prezantuar si pasuri kontingjente.	Pagesa e parregullt për stafin. Mos shpalosja e pasurive kontingjente; Mos pajtueshmëri me LPP; Kompensimi i parregullt i grupeve punuese për hartimin e strategjisë për digjitalizim. Mangësi në menaxhimin e parasë së gatshme.
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave	0,30	Agjencia ka shpalosur vlerën e pasurive fikse në PVF, mirëpo pasuritë nuk i ka regjistruar në SIMFK	Mos regjistrimi i pasurive fikse në SIMFK; Mos përgatitja e planit të Prokurimit; Planifikim jo i mire i shpenzimeve; Mos plotësimi i deklaratave vetë vlerësuese; Mos mbyllja e avansit për udhëtime jashtë vendit; Menaxhim jo i mirë i borxheve
Paneli për Zgjedhje dhe Ankesa	0,26	Informatat mbi pasuritë nën 1000€ nuk janë të plota dhe të sakta	Planifikim jo i mirë i buxhetit; Mos pajtueshmëri me LPP
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës	0,25	Nuk ka shpalosur vlerën e pasurive jo kapitale nën 1,000 në PVF dhe pasuritë kontingjente i ka shpalosur gabimisht si detyrime kontingjente	Mos adresimi i plotë i rekomandimeve të ZAP -it; Mos plotësimi i deklaratave vetë vlerësuese; Regjistrimi i shpenzimeve në kode ekonomike jo adekuate; Furnizim me mbushje për telefona mobil pa kontratë; Mos plotësimi i vendeve të lira të punës; Menaxhim jo i mirë i automjeteve; Mos regjistrimi i shpenzimeve nën 1000€.

## ZYRA E AUDITORIT PËR GJITHSHËM

**Tabela 4: Opinionet e kualifikuara**

Subjektet e Audituar	Buxheti final (mil.euro)	Arsyeja për kualifikimi e opinionit (çështjet me ndikim material)	Mangësitë kryesore menaxheriale
Agjencia Kosovare e Privatizimit	8,08	Pagesa për realizimin e shpenzimeve profesionale të likuidimit nuk është shpalosur në PVF	Mos adresimi i rekomandimeve të ZAP-it; Planifikim jo i mirë i buxhetit; Pagesa e shërbimeve të likuidimit nga fondet e NSH-ve në likuidim; Mos pajtueshmëri me LPP; Certifikim i parregullt i pagesave; Mungesë e politikave të kompensimit; Mosrespektim i kriterëve gjatë rekrutimit; Ristrukturimi i vendeve të punës pa respektimin e procedurave
Fondi i privatizimit	0,00	Pagesa për realizimin e shpenzimeve profesionale të likuidimit pa bazë ligjore	Mos adresimi i rekomandimeve të ZAP-it; Vonesa në përzgjedhjen e Bordit të Drejtorëve; Përdorimi i fondeve të NSH-ve në likuidim para likuidimit të ndërmarrjeve; Aktivizimi i ulët i fondeve të mirëbesimit; Shpërndarja e 20%-shit të listave të punëtorëve në disa raste nuk bëhet në harmoni me rregullat e paracaktuara; Mungesë e kriterëve të shkruara kur kërkohet shtyrja e afatit për pagesë dhe shtyrja e afatit për verifikimin e së kaluarës së blerësve të NSH-ve.

**Tabela 5: Opinionet e kualifikuara me Theksim të çështjes**

Subjektet e Audituar	Buxheti (000 euro)	Arsyeja për kualifikimi e opinionit (çështjet me ndikim material)	Mangësitë kryesore menaxheriale
Prizren	33,17	Mos prezantimi i pagesave nga palët e treta; Mos prezantimi i donacioneve	Mos adresimi i plot i rekomandimeve të ZAP-it; Mos respektimi i procedurave të prokurimit; Mungesa e një baze të qartë për lejet e ndërtimit
Drenas	10,42	Të hyrat vetjake jo të plota dhe pagesat nga palët e treta nuk ishin paraqitur fare në PVF. Theksimi i çështjes: informatat e prezantuara tek shpalosjet e pasurive dhe stoqeve nuk ishin të sakta.	PVF jo në pajtim me në pajtim me kërkesat e Rr.F nr. 07/2011, dhe SNKSP; Mos adresimi i plotë i rekomandimeve të ZAP-it; Realizim i dobët i buxhetit për të hyra dhe nivel i lartë i të arkëtueshmeve, Mungesa e një baze të qartë për lejet e ndërtimit dhe për pronat e dhëna me qira; Hyrja në obligime kontraktuale pa pasur buxhet të aprovuar
Istog	8,24	Të hyrat vetjake të prezantuar në mënyrë jo të drejtë dhe pagesat nga palët e treta nuk ishin paraqitur fare në PVF	Mangësi në inkasimin e të hyrave vetjake; Menaxhim jo i mirë i kontratave; Mungesa e rregulloreve për subvencione; Kontrolle jo të mira në procesin e pagesave; Regjistri kontabël i pasurisë jo i plotë dhe i saktë.

## RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT 2012

Kaçanik	5,91	Informacioni i shpalosur mbi pasuritë si dhe pagesat nga palët e treta nuk përputheshin me regjistrat përkatës	Planifikim dhe inkasim i dobët i të hyrave vetjake dhe shmangie e procedurave të prokurimit publik;
Mamusha	1,15	Shpalosja e pasurisë dhe paraqitja e të arkëtueshmeve	Planifikim dhe inkasim i dobët i të hyrave vetjake dhe shmangie e procedurave të prokurimit.
Trepça	0,00	Shpalosje e pasaktë dhe jo e plotë e pasurive. Mungesa e informatave të krahasueshme nga viti i kaluar dhe mos prezantimi i tatimeve dhe kontributeve në PVF-të për Trepçën veri. Theksim i çështjes: mungesa e informatave për detyrimet kontigjente dhe mos zbulimi i rezervave minerare.	Mangësi në cilësinë e informatave në PVF; Planifikimi jo i mirë i buxhetit; Mangësi në planifikimin dhe menaxhimin e prokurimit; Mangësi në menaxhimin e personelit; Mangësi në inkasimin e borxheve; Mos regjistrimi me kohë dhe i drejtë i transaksioneve në kontabilitet; Regjistrat jo të plotë dhe të saktë të pasurive.

**Tabela 6: Mohimet e opinionit**

Subjektet e Audituar	Buxheti final (mil. euro)	Arsyeja për mohim të opinionit
Leposaviq	2.96	Nuk janë prezantuar PVF
Zubin Potok	1,99	Nuk janë prezantuar PVF
Zveçan	1.88	Nuk janë prezantuar PVF